



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Plani Strategjik 2026–2030

Per Scientiam ad Futurum
(Përmes dijes, drejt së ardhmes)

Qershor 2026

Lista e Shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
AI	Inteligjenca Artificiale
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
EHEA	European Higher Education Area
EQF	European Qualifications Framework
ERP	Enterprise Resource Planning
ESG	Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area
EU	Bashkimi Evropian
GDPR	General Data Protection Regulation
IoH	Internationalization at Home
KPI	Key Performance Indicator
LMS	Learning Management System
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NOC	Network Operations Center
NJA	Njësi Akademike
OJQ	Organizatë Joqeveritare
QPM	Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
RIS	Research Information System
SEMS	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve
SHER	Supporting Higher Education Reform
SOC	Security Operations Center
SWOT	Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TTO	Technology Transfer Office
UP	Universiteti i Prishtinës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Hyrje	7
3. Procesi i hartimit të Planit Strategjik 2026–2030	8
3.1. Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik.....	8
3.2. Organizimi i procesit të hartimit	8
3.3. Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2023–2025.....	8
4. Metodologjia dhe procesi konsultativ	11
5. Analiza e gjendjes aktuale	12
5.1. Historiku dhe profili institucional i Universitetit të Prishtinës	12
5.2. Konteksti institucional dhe zhvillimet në arsimin e lartë	16
5.3. Analiza SWOT	18
6. Korniza strategjike e Universitetit të Prishtinës 2026–2030	21
6.1. Vizioni	21
6.2. Misioni	21
6.3. Vlerat dhe parimet strategjike	21
6.4. Shtyllat strategjike dhe objektivat strategjikë 2026–2030	22
6.4.1 Ekselenca akademike	22
6.4.2 Përvoja studentore	25
6.4.3 Kërkimi dhe inovacioni	28
6.4.4 Ndërkombëtarizimi	33
6.4.5 Qeverisja dhe qëndrueshmëria.....	35
6.4.6 Transformimi digjital	38
7. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2026–2030	41
8. Ndikimet financiare dhe qëndrueshmëria e zbatimit	42
9. Shtojcat.....	43
9.1. Lista e dokumenteve referuese	43
9.2. Lista e pjesëmarrësve në procesin konsultativ	44
9.3. Plani i Veprimit 2026–2028.....	45

1. Përmbledhje ekzekutive

Plani Strategjik 2026–2030 i Universitetit të Prishtinës paraqet vizionin, prioritetet dhe drejtimin zhvillimor të institucionit për pesë vjetët e ardhshëm. Strategjia përcakton rrugën për transformimin e Universitetit të Prishtinës në një universitet modern, kërkimor, inovativ dhe ndërkombëtarisht konkurrues, i cili kontribuon në mënyrë aktive në zhvillimin demokratik, ekonomik, social dhe kulturor të Kosovës dhe rajonit.

I hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me komunitetin akademik, studentët, partnerët institucionalë, sektorin privat dhe ekspertët ndërkombëtarë, strategjia reflekton aspiratat e Universitetit të Prishtinës për të forcuar rolin e tij si institucioni kryesor i arsimit të lartë në Kosovë dhe si partner i besueshëm në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit.

Strategjia bazohet në analizën e progresit të arritur gjatë zbatimit të Planit Strategjik 2023–2025, në vlerësimin e sfidave aktuale dhe në trendet globale që po e transformojnë arsimin e lartë. Digjitalizimi, inteligjenca artificiale, ndërkombëtarizimi, shkenca e hapur, zhvillimi i qëndrueshëm, financimi i bazuar në performancë dhe kërkesat për ndikim më të madh shoqëror janë faktorë që po i riformësojnë universitetet në mbarë botën. Në këtë kontekst, Universiteti i Prishtinës synon të pozicionohet si një institucion që jo vetëm u përshtatet këtyre ndryshimeve, por edhe i udhëheq ato në nivel kombëtar.

Plani Strategjik 2026–2030 udhëhiqet nga vizioni që Universiteti i Prishtinës të afirmohet si universitet lider në rajon dhe partner i besueshëm në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, i njohur për ekselencë akademike, kërkim dhe inovacion me ndikim shoqëror, ndërkombëtarizim, transformim digjital dhe kontribut aktiv në zhvillimin demokratik dhe të qëndrueshëm të shoqërisë.

Për realizimin e këtij vizioni, strategjia organizohet rreth gjashtë shtyllave kryesore strategjike.

Ekselencia akademike

Ekselencia akademike mbetet themeli i zhvillimit të Universitetit të Prishtinës. Në periudhën 2026–2030 universiteti do të fokusohet në modernizimin e vazhdueshëm të programeve studimore, harmonizimin e tyre me standardet evropiane të cilësisë dhe përshtatjen me nevojat e ekonomisë dhe tregut të punës.

Universiteti synon që të gjitha programet studimore të rishikohen në mënyrë periodike dhe të bazohen në rezultate të të nxënit, kompetenca profesionale dhe zhvillimet më të fundit shkencore. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të programeve inovative dhe ndërdisiplinore në fusha me potencial të lartë zhvillimi, si inteligjenca artificiale, transformimi digjital, qëndrueshmëria, shkencat e të dhënave dhe inovacioni social.

Mësimdhënia do të transformohet përmes metodave bashkëkohore pedagogjike, mësimi të orientuar te studenti, integriteti të teknologjive digjitale dhe zhvillimit profesional të stafit akademik. Në të njëjtën kohë, universiteti do të fuqizojë programet e doktoratës, do të zgjerojë ofertën akademike në gjuhën angleze dhe do të krijojë mundësi të reja për edukim të vazhdueshëm dhe mikro-kredenciale në funksion të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Përvoja studentore

Studenti vendoset në qendër të të gjitha proceseve akademike dhe administrative. Universiteti synon të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës, mbështetës dhe stimulues, ku secili student ka mundësi të zhvillojë potencialin e tij akademik, profesional dhe personal.

Gjatë kësaj periudhe, do të modernizohen shërbimet studentore, do të zhvillohen modele të reja të këshillimit akademik dhe profesional, do të forcohen mekanizmat e mentorimit dhe do të krijohen sisteme të avancuara të mbështetjes psikologjike dhe sociale. Një prioritet i rëndësishëm do të jetë rritja e punësueshmërisë së studentëve përmes praktikave profesionale, bashkëpunimit me industrinë dhe institucionet publike, si dhe monitorimit sistematik të karrierës së të diplomuarve. Universiteti synon që përvoja studentore të mos kufizohet vetëm në procesin e studimit, por të shtrihet në zhvillimin e kompetencave për jetën, qytetarinë aktive dhe karrierën profesionale.

Kërkimi dhe inovacioni

Universiteti i Prishtinës synon të avancojë nga një universitet kryesisht mësimdhënës në një universitet me profil më të fuqishëm kërkimor dhe inovativ.

Strategjia parasheh rritjen e kapaciteteve kërkimore, fuqizimin e grupeve dhe qendrave kërkimore, krijimin e infrastrukturës moderne laboratorike dhe rritjen e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të financimit të kërkimit. Universiteti do të promovojë kërkimin ndërdisiplinor dhe bashkëpunimin ndërmjet fushave të ndryshme shkencore për adresimin e sfidave komplekse shoqërore, ekonomike dhe mjedisore. Një prioritet i veçantë do të jetë zhvillimi i inovacionit, transferit të teknologjisë dhe bashkëpunimit me industrinë. Përmes qendrave të inovacionit, zyrave të transferit të teknologjisë dhe partneriteteve me sektorin privat, universiteti synon të rrisë ndikimin e kërkimit në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Paralelisht, do të forcohet kultura e shkencës së hapur, integritetit akademik dhe etikës kërkimore, duke siguruar që kërkimi shkencor të jetë cilësor, transparent dhe me ndikim ndërkombëtar.

Ndërkombëtarizimi

Ndërkombëtarizimi do të shërbejë si një nga mekanizmat kryesorë për rritjen e cilësisë, reputacionit dhe konkurrueshmërisë së universitetit. Universiteti do të zgjerojë mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit, do të zhvillojë partneritete strategjike afatgjata me universitete prestigjioze dhe do të rrisë pjesëmarrjen në rrjetet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të programeve të përbashkëta, diplomave të dyfishta dhe programeve doktorale ndërkombëtare. Po ashtu, universiteti do të forcojë lidhjet me diasporën akademike shqiptare dhe do ta shndërrojë atë në një burim strategjik për mentorim, kërkim, mësimdhënie dhe bashkëpunim institucional.

Qëllimi afatgjatë është që ndërkombëtarizimi të mos perceptohet vetëm si mobilitet, por si integrim i plotë në ekosistemin global të dijes dhe inovacionit.

Qeverisja dhe qëndrueshmëria

Strategjia synon ndërtimin e një sistemi modern, transparent dhe të bazuar në performancë të qeverisjes universitare. Universiteti do të avancojë planifikimin strategjik, monitorimin e performancës, menaxhimin e cilësisë dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë. Në të njëjtën kohë, do të zhvillohen mekanizma të rinj për menaxhimin e burimeve njerëzore, vlerësimin e performancës dhe zhvillimin profesional të stafit.

Kultura organizative do të mbështetet në integritet, bashkëpunim, transparencë dhe llogaridhënie. Strategjia gjithashtu parasheh forcimin e qëndrueshmërisë financiare përmes diversifikimit të burimeve të financimit, rritjes së pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare dhe zhvillimit të mekanizmave për gjenerimin e të hyrave nga aktivitetet akademike dhe kërkimore.

Në harmoni me prioritetet globale, universiteti do të integrojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konceptin e "Green Campus" në funksionimin institucional.

Transformimi digjital

Transformimi digjital përfaqëson dimensionin horizontal që mbështet realizimin e të gjitha objektivave strategjike. Universiteti synon të ndërtojë një ekosistem digjital të integruar, i cili mundëson procese më efikase, shërbime më cilësore dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Digjitalizimi do të përfshijë proceset akademike, administrative, kërkimore dhe të sigurimit të cilësisë.

Një prioritet i rëndësishëm do të jetë integrimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe administrim universitar, duke garantuar njëkohësisht përdorim etik dhe të përgjegjshëm të saj. Strategjia parasheh gjithashtu forcimin e sigurisë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe zhvillimin e kompetencave digjitale të stafit dhe studentëve. Transformimi digjital synon ta bëjë Universitetin e Prishtinës një institucion më inovativ, më efikas dhe më të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Përmes zbatimit të kësaj strategjie, Universiteti i Prishtinës synon të konsolidojë pozitën e tij si institucioni kryesor akademik në Kosovë, të rrisë ndikimin e tij në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit dhe të forcojë praninë e tij në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë.

Strategjia 2026–2030 nuk paraqet vetëm një plan veprimi institucional, por një vizion transformues për të ardhmen e universitetit. Ajo synon të krijojë një universitet edhe më cilësor, më inovativ, më ndërkombëtar, më të qëndrueshëm dhe më të orientuar drejt nevojave të studentëve, shoqërisë dhe ekonomisë së dijes së shekullit XXI.

2. Hyrje

I themeluar në vitin 1970, Universiteti i Prishtinës është institucioni më i madh dhe më i vjetër i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe një nga institucionet më të rëndësishme akademike në rajon. Që nga themelimi i tij, universiteti ka luajtur rol kyç në zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor dhe shoqëror të Kosovës, duke kontribuar në përgatitjen e gjeneratave të profesionistëve, studiuesve dhe udhëheqësve në fusha të ndryshme të jetës publike dhe akademike. Universiteti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe standardet evropiane të arsimit të lartë.

Universiteti i Prishtinës përbëhet nga 14 njësi akademike dhe ofron programe studimi në të tri nivelet e studimit – bachelor, master dhe doktoratë – në fusha të ndryshme akademike dhe profesionale. Universiteti ka 23,351 studentë aktivë, rreth 1,000 staf akademik dhe mbi 250 punonjës administrativ, duke përfaqësuar komunitetin më të madh universitar në vend. Përmes programeve të akredituara dhe pjesëmarrjes në proceset kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë, universiteti synon të avancojë vazhdimisht standardet akademike dhe institucionale. Proceset e akreditimit, zhvillimi i programeve të reja dhe harmonizimi me standardet evropiane mbeten ndër prioritetet kryesore institucionale.

Misioni i Universitetit të Prishtinës është të ofrojë arsimim dhe edukim akademik cilësor, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe shërbime për komunitetin dhe shoqërinë. Universiteti synon të funksionojë si qendër e ekselencës dhe inovacionit, duke bashkëvepruar me zhvillimet shoqërore dhe globale në funksion të zhvillimit të demokracisë, ekonomisë së vendit, konkurrueshmërisë ndërkombëtare dhe vlerave të një shoqërie demokratike dhe të qëndrueshme.

Me moton “Përmes dijes, drejt së ardhmes”, vizioni i Universitetit të Prishtinës është të afirmohet si universitet lider në rajon dhe partner i besueshëm në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, i njohur për ekselencë akademike, kërkim dhe inovacion me ndikim shoqëror, ndërkombëtarizim, transformim digjital dhe kontribut aktiv në zhvillimin demokratik dhe të qëndrueshëm të shoqërisë.

Po ashtu, Universiteti i Prishtinës synon të forcojë më tej rolin e tij si institucion aktiv në transformimin shoqëror, zhvillimin demokratik dhe adresimin e sfidave globale përmes arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit social dhe bashkëpunimit me komunitetin dhe institucionet publike. Universiteti do të promovojë angazhimin qytetar, mendimin kritik, zhvillimin e qëndrueshëm dhe kontributin në politikat publike në funksion të zhvillimit të Kosovës dhe integritetit evropian.

Plani Strategjik 2026–2030 paraqet dokumentin kryesor zhvillimor të universitetit për pesë vjetët e ardhshëm dhe përcakton orientimin institucional drejt forcimit të ekselencës akademike, avancimit të kërkimit shkencor dhe inovacionit, përmirësimit të përvojës studentore, thellimit të ndërkombëtarizimit, modernizimit të qeverisjes dhe përshpejtimit të transformimit digjital. Strategjia ndërtohet mbi përvojat dhe progresin e arritur gjatë zbatimit të Planit Strategjik 2023–2025, si dhe mbi gjetjet dhe rekomandimet e raportit të monitorimit të këtij cikli strategjik.

Ky plan strategjik është hartuar në përputhje me prioritetet kombëtare të arsimit të lartë dhe dokumentet relevante strategjike të Republikës së Kosovës, veçanërisht me Strategjinë e Arsimit 2022–2026 dhe politikat për financimin e bazuar në performancë të institucioneve publike të arsimit të lartë.

3. Procesi i hartimit të Planit Strategjik 2026–2030

3.1. Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik

Plani Strategjik 2026–2030 i Universitetit të Prishtinës është hartuar si dokumenti kryesor orientues për zhvillimin institucional të universitetit në periudhën afatmesme, duke synuar forcimin e cilësisë akademike, kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimit, transformimit digjital dhe qeverisjes institucionale. Hartimi i këtij plani është udhëhequr nga nevoja për t’iu përgjigjur zhvillimeve të reja në arsimin e lartë, kërkesave të tregut të punës, proceseve të integritetit evropian dhe transformimeve teknologjike që po ndikojnë në funksionimin e universiteteve moderne.

Strategjia synon të krijojë një kornizë të qartë zhvillimore për Universitetin e Prishtinës, të bazuar në objektiva të matshme, priorite institucionale dhe mekanizma të monitorimit dhe llogaridhënies. Në të njëjtën kohë, ajo reflekton aspiratën e universitetit për t’u pozicionuar si institucion lider në rajon për cilësi akademike, kërkim shkencor dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

3.2. Organizimi i procesit të hartimit

Procesi i hartimit të Planit Strategjik 2026–2030 është zhvilluar mbi baza gjithëpërfshirëse, transparente dhe pjesëmarrëse. Me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, të datës 15.01.2026, është themeluar Komisioni për Hartimin e Planit Strategjik. Komisioni është udhëhequr nga prof. Mimoza Ibrani, në cilësinë e kryesueses, dhe është përbërë nga prof. Majlinda Gjellaj, dr. Arbëresha Nela-Turjaka, znj. Myesere Hoxha, prof. Kurtesh Sherifi, prof. Albana Berisha-Qehaja, prof. Violeta Nushi, prof. Shpetim Elezi, përfaqësuesi i studentëve, z. Bujar Abiti, përfaqësuesi i SHER-it, z. Nehat Dervishi, dhe U.D. i sekretarit të përgjithshëm, z. Safet Thaçi.

Komisioni ka pasur për detyrë koordinimin e procesit të hartimit të strategjisë, zhvillimin e draftit fillestar, organizimin e konsultimeve me palët e interesit dhe formulimin e prioritetëve strategjike të universitetit. Procesi është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me njësitë akademike, strukturat administrative, studentët dhe partnerët institucionalë të universitetit, duke siguruar përfshirje të gjerë dhe reflektim të nevojave dhe prioritetëve të komunitetit universitar.

Procesi i hartimit të strategjisë është mbështetur nga ekspertiza e ofruar nga SHER-i, përmes ekspertit z. Jeton Mehmeti, i cili ka bërë monitorimin e zbatimit të strategjisë paraprake dhe ka ofruar mbështetjen profesionale për hartimin e kësaj strategjie.

3.3. Vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2023–2025

Hartimi i Planit Strategjik 2026–2030 është mbështetur në gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Monitorimit të Planit Strategjik 2023–2025¹, i realizuar përmes analizës së raporteve vetëvlerësuese të njësive akademike, diskutimeve me strukturat drejtuese të universitetit dhe punëtorive konsultative, të organizuara gjatë vitit 2025. Ky proces ka

¹ Universiteti i Prishtinës, *Raporti i Monitorimit të Planit Strategjik 2023–2025: Vlerësimi i progresit dhe rekomandimet për ciklin 2026–2030*, Prishtinë, dhjetor 2025.

mundësuar identifikimin e progresit të arritur, sfidave të mbetura dhe prioritetëve që duhet të adresohen në ciklin e ardhshëm strategjik.

Në përgjithësi, vlerësimi tregon se Universiteti i Prishtinës ka shënuar progres të konsiderueshëm në shumicën e objektivave të përcaktuara në strategjinë 2023–2025. Përparimi ka qenë veçanërisht i dukshëm në fushën e sigurimit të cilësisë, zhvillimit të kapaciteteve të stafit akademik, ndërkombëtarizimit, modernizimit të proceseve mësimore dhe investimeve në infrastrukturën akademike e kërkimore. Fakultetet kanë avancuar në rishikimin dhe riakreditimin e programeve të studimit, janë zgjeruar mundësitë për mobilitet akademik dhe janë krijuar partneritete të reja ndërkombëtare. Gjithashtu, janë bërë investime të rëndësishme në laboratorë, pajisje teknologjike dhe sisteme digjitale si SEMS dhe DMS, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e përvojës së studentëve.

Në shtyllën e parë strategjike, e fokusuar në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, universiteti ka arritur të institucionalizojë në masë të madhe kulturën e sigurimit të cilësisë, të forcojë rolin e Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie dhe të modernizojë kurrikulat në shumicën e njësive akademike. Megjithatë, raporti evidenton se ende mungon një sistem i unifikuar për monitorimin e performancës akademike dhe vlerësimin krahasues ndërmjet njësive akademike. Kjo gjetje ka ndikuar drejtpërdrejt në përfshirjen e objektivave të reja në Strategjinë 2026–2030 që lidhen me zhvillimin profesional të stafit, modernizimin pedagogjik dhe fuqizimin e mekanizmave të matjes së performancës institucionale.

Në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, raporti konstaton se universiteti ka rritur ndjeshëm pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare, ka modernizuar laboratorët dhe ka zgjeruar bashkëpunimin me sektorin privat. Megjithatë, rezultatet tregojnë se komercializimi i kërkimit shkencor, menaxhimi i pronësisë intelektuale dhe transferi i teknologjisë mbeten fusha ende të pakonsoliduara. Për këtë arsye, Strategjia 2026–2030 e vendos kërkimin dhe inovacionin si një nga shtyllat qendrore të zhvillimit institucional, duke synuar transformimin e kërkimit shkencor në një motor të zhvillimit akademik, ekonomik dhe shoqëror.

Një nga sukseset më të dukshme të periudhës 2023–2025 ka qenë ndërkombëtarizimi. Universiteti ka zgjeruar rrjetin e partneriteteve ndërkombëtare, ka rritur numrin e mobiliteteve të studentëve dhe stafit, ka zhvilluar programe në gjuhën angleze dhe ka rritur pjesëmarrjen në programe si Erasmus+, Horizon Europe dhe CEEPUS. Megjithatë, raporti identifikon nevojën për një qasje më sistematike ndaj ndërkombëtarizimit, përfshirë zhvillimin e kompetencave ndërkulturore, përfshirjen e diasporës akademike dhe forcimin e brendimit ndërkombëtar të universitetit. Këto gjetje janë reflektuar drejtpërdrejt në shtyllën e re strategjike për ndërkombëtarizimin gjithëpërfshirës gjatë periudhës 2026–2030.

Raporti evidenton gjithashtu progres të rëndësishëm në digjitalizimin e proceseve mësimore dhe administrative. Zbatimi i platformës SEMS, përdorimi i materialeve digjitale dhe investimet në infrastrukturën TIK kanë krijuar bazën për transformimin digjital të universitetit. Megjithatë, niveli i digjitalizimit mbetet i pabarabartë ndërmjet njësive akademike dhe mungon ende një kornizë e plotë institucionale për transformimin digjital. Pikërisht për këtë arsye, Strategjia 2026–2030 e trajton transformimin digjital si një shtyllë të veçantë strategjike, duke synuar integrimin e plotë të proceseve akademike, administrative dhe vendimmarrëse në sisteme moderne digjitale.

Në aspektin e qeverisjes dhe menaxhimit institucional, vlerësimi tregon se janë bërë hapa të rëndësishëm në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit akademik. Megjithatë, raporti identifikon nevojën për forcimin e menaxhimit të bazuar në performancë, planifikimin afatgjatë të burimeve dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet njësive akademike dhe administratës qendrore. Kjo ka ndikuar në formulimin e shtyllës së re strategjike për qeverisje dhe qëndrueshmëri, e cila synon të forcojë kapacitetet institucionale dhe kulturën e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Si përfundim, vlerësimi i Planit Strategjik 2023–2025 është përdorur si pikënisje për transformimin e mëtejshëm të Universitetit të Prishtinës. Shumica e prioriteteve të Strategjisë 2026–2030 burojnë drejtpërdrejt nga gjetjet e këtij vlerësimi. Nëse strategjia e mëparshme ishte e fokusuar kryesisht në konsolidimin e proceseve themelore të cilësisë, ndërkombëtarizimit dhe digjitalizimit, strategjia e re synon një fazë më ambicioze zhvillimi, të orientuar drejt ekselencës akademike, kërkimit dhe inovacionit, transformimit digjital, ndërkombëtarizimit të avancuar dhe qeverisjes së qëndrueshme. Në këtë mënyrë sigurohet një vazhdimësi logjike ndërmjet dy cikleve strategjike dhe një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet rezultateve të arritura, mësimave të nxjerra dhe prioriteteve të reja zhvillimore.

4. Metodologjia dhe procesi konsultativ

Procesi i hartimit të Planit Strategjik 2026–2030 është zhvilluar përmes një metodologjie konsultative dhe të bazuar në evidencë, me synim sigurimin e përfshirjes së gjerë institucionale dhe harmonizimin e strategjisë me nevojat reale të universitetit dhe zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë.

Metodologjia është mbështetur në analizën e dokumenteve strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësimin e praktikave evropiane në arsimin e lartë, Raportin e Monitorimit të Planit Strategjik 2023–2025, analizën SWOT, monitorimin e strategjisë paraprake dhe konsultimet me palët relevante brenda dhe jashtë universitetit.

Procesi konsultativ ka përfshirë anëtarët e Këshillit Drejtues, rektorin, prorektorët, dekanët, personelin akademik dhe administrativ, studentët dhe partnerë të tjerë institucionalë. Gjatë procesit, janë organizuar dy punëtori, njëmbëdhjetë takime të rregullta të grupit punues, konsultime tematike dhe diskutime mbi prioritetet zhvillimore të universitetit.

Konsultimet kanë filluar me analizën e zbatimit të Planit Strategjik 2023–2025 dhe kanë vazhduar me identifikimin e prioriteteve strategjike, diskutimin e objektivave, aktiviteteve dhe indikatorëve kyç të performancës për periudhën 2026–2030. Procesi është karakterizuar nga përfshirja aktive e studentëve dhe komunitetit universitar në formulimin e prioriteteve dhe objektivave të strategjisë.

Gjatë procesit, janë analizuar praktika dhe modele strategjike të universiteteve evropiane, si dhe trendet bashkëkohore në fushat e transformimit digjital, inteligjencës artificiale, kërkimit shkencor, zhvillimit të qëndrueshëm, ndërkombëtarizimit dhe qeverisjes universitare.

Qasja konsultative dhe pjesëmarrëse ka synuar të sigurojë transparencë, pronësi institucionale dhe qëndrueshmëri të procesit strategjik, duke reflektuar aspiratat dhe prioritetet zhvillimore të Universitetit të Prishtinës për periudhën 2026–2030.

Plani Strategjik 2026–2030 është hartuar në përputhje me Statutin e Universitetit të Prishtinës, prioritetet kombëtare të arsimit të lartë dhe dokumentet relevante strategjike të Republikës së Kosovës. Po ashtu, dokumenti reflekton parimet e financimit të bazuar në performancë të institucioneve publike të arsimit të lartë, duke integruar objektiva të matshme, indikatorë të performancës dhe mekanizma monitorimi institucional.

Gjatë procesit të hartimit, janë analizuar edhe praktika dhe modele strategjike të universiteteve evropiane, përfshirë Strategjinë 2022–2027 të Universitetit të Lubjanës, e cila ka shërbyer si referencë për qasjen gjithëpërfshirëse dhe orientimin drejt zhvillimit institucional afatgjatë.

Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës do të përcillet fillimisht me Planin trevjeçar të Veprimit, i cili do të përcaktojë prioritetet operative, përgjegjësitë institucionale, afatet kohore dhe mekanizmat e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e objektivave strategjike.

5. Analiza e gjendjes aktuale

5.1. Historiku dhe profili institucional i Universitetit të Prishtinës

Universiteti i Prishtinës është institucioni më i madh dhe më i rëndësishëm i arsimit të lartë në Kosovë. Ai u themelua me Ligjin mbi Themelimin e Universitetit të Prishtinës, të miratuar nga Kuvendi i Krahinës Socialiste të Kosovës, më 18 nëntor 1969. Themelimi i universitetit përbënte një ngjarje historike me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin arsimor, kulturor dhe shkencor të Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Kuvendi themelues i universitetit u mbajt më 13 shkurt 1970, ndërsa më 15 shkurt 1970 u organizua mbledhja solemne e Kuvendit, datë e cila sot shënohet si Dita e Universitetit të Prishtinës.

Në përbërjen fillestare të universitetit ishin vetëm katër fakultete: Fakulteti Filozofik, Fakulteti Juridiko-Ekonomik, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Mjekësisë. Gjatë dekadave, Universiteti i Prishtinës ka kaluar nëpër procese të shumta zhvillimi dhe reformimi akademik, duke u konfirmuar gjithnjë në institucionin kryesor universitar në vend.

Sot, Universiteti i Prishtinës operon me 14 njësi akademike:

- Fakulteti Filozofik
- Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
- Fakulteti i Filologjisë
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Arteve
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- Fakulteti i Shkencave Sportive
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Arkitekturës

Qeverisja

Organet kryesore drejtuese të Universitetit të Prishtinës janë Këshilli Drejtues, Senati dhe Rektori. Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë strategjike për funksionimin efektiv institucional të universitetit.

Senati i universitetit është organi më i lartë akademik dhe drejtohet nga rektori, i cili është autoriteti kryesor menaxhues i universitetit. Rektori udhëheq punën akademike dhe administrative dhe siguron funksionimin e rregullt të universitetit, në përputhje me politikat e përcaktuara nga Këshilli Drejtues. Ai ndihmohet nga prorektorët dhe sekretari i përgjithshëm i universitetit, ndërsa detyrat e prorektorëve përcaktohen nga rektori sipas Statutit të UP-së.

Sekretari i përgjithshëm është zyrtari më i lartë ekzekutiv dhe administrativ i universitetit dhe i përgjigjet rektorit për administrim efikas, ekonomik dhe efektiv në të gjitha nivelet e universitetit.

Studimet në Universitetin e Prishtinës janë pa pagesë, ndërsa një numër i konsiderueshëm studentësh, rreth 4000, shfrytëzojnë shërbimet e konvikteve dhe mensës studentore. Po ashtu, Universiteti i Prishtinës ndan bursa të ekselencës për studentët me notë mesatare të lartë.

Profili akademik

Universiteti i Prishtinës sot ofron rreth 140 programe studimore në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoratë në fusha të ndryshme shkencore dhe profesionale. Aktualisht, UP-ja numëron 23,351 studentë aktivë, rreth 1000 anëtarë të personelit akademik me 203 profesorë të rregullt, 214 profesorë të asociuar, 209 profesorë asistentë dhe 300 asistentë, ndërsa pjesë e personelit janë edhe rreth 250 punëtorë të administratës. Universiteti ka zgjeruar vazhdimisht ofertën akademike dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, po ashtu edhe numri i personelit akademik dhe atij administrativ është në rritje e sipër përmes hapjes së konkurseve të reja, duke synuar harmonizimin me standardet evropiane të arsimit të lartë dhe Procesin e Bolonjës.

Programet BA/BSc

Në nivelin bachelor, universiteti ofron një bazë të fortë studimore në fusha tradicionale dhe profesionale, si psikologjia, sociologjia, historia, gjuhët dhe letërsitë, drejtësia, ekonomia dhe menaxhmenti, shkencat matematike dhe natyrore, inxhinieritë (ndërtimore, mekanike, elektrike dhe kompjuterike), mjekësia, edukimi, sporti, arkitektura dhe artet. Këto programe fokusohen në ndërtimin e kompetencave themelore teorike dhe praktike, duke përgatitur studentët për tregun e punës ose për vazhdimin e studimeve në ciklet më të avancuara.

Programet MA/MSc

Programet master shfaqin një orientim më të theksuar drejt specializimit dhe ndërdisiplinartetit. Në këtë nivel ofrohen programe në ekonomi financiare dhe menaxhim, juridik, shkenca të edukimit, shkenca natyrore dhe teknologjike, arte pamore dhe performative, si dhe fusha të avancuara të inxhinierisë dhe arkitekturës. Profili i MA/MSc thekson zhvillimin e aftësive analitike, kërkimore dhe profesionale, duke përgatitur studentët për role eksperte në institucione publike, industri apo në kërkim shkencor.

Programet e doktoratës

Programet doktorale përfaqësojnë nivelin më të lartë të profilit akademik dhe fokusohen në kërkimin shkencor të avancuar në fusha si shkencat natyrore, juridiku, edukimi, inxhinieritë, mjekësia dhe artet. Këto programe synojnë zhvillimin e studiuesve të pavarur, rritjen e prodhimit shkencor dhe integrimin e universitetit në hapësirën evropiane të kërkimit dhe arsimit të lartë.

Në tërësi, profili akademik i programeve BA, MA dhe PhD (shih tabelën 1) në Universitetin e Prishtinës reflekton një strukturë të balancuar midis disiplinave klasike akademike dhe fushave profesionale moderne. Ai karakterizohet nga diversiteti i programeve, orientimi drejt kërkimit dhe ndërkombëtarizimit, si dhe nga përpjekjet për të harmonizuar ofertën studimore me kërkesat e tregut të punës dhe standardet evropiane të arsimit të lartë.

Qendrat dhe institutet

Në kuadër të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës funksionojnë 18 qendra dhe institute, të cilat kanë për qëllim forcimin e lidhjes ndërmjet programeve studimore dhe tregut të punës, transferin e dijes dhe teknologjisë, si dhe kontributin shoqëror në zhvillimin e politikave dhe proceseve të rëndësishme në vend dhe më gjerë. Këto qendra luajnë rol të rëndësishëm në avancimin e cilësisë akademike, zhvillimin profesional dhe bashkëpunimin me komunitetin dhe institucionet relevante.

Ndër qendrat me rëndësi të veçantë në nivel qendror funksionojnë Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie dhe Qendra për Zhvillim të Karrierës. Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të stafit akademik përmes trajnimeve, punëtorive dhe mbështetjes për përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ndërkaq, Qendra për Zhvillim të Karrierës mbështet studentët në zhvillimin e shkathtësive për tregun e punës, ofron mundësi praktike dhe informon për studime, trajnime dhe mundësi punësimi, duke lehtësuar tranzicionin e studentëve nga studimet në karrierë profesionale.

Tabela 1. Numri i programeve të ofruara në tri nivelet, gjatë tre vjetëve të fundit

	2023	2024	2025
BA/BSc/integruara	64	62	63
MA/MSc/integruara	68	69	70
PhD	4	8	8

Studentët


Gjatë periudhës 2023–2025 (shih Tabelën 2), niveli Baçelor (BA) ka përfaqësuar numrin më të madh të studentëve aktivë, me mbi 17 mijë studentë në secilin vit akademik. Kjo tregon se studimet bachelor vazhdojnë të jenë niveli më i frekuentuar në universitet.

Në nivelin Master (MA), numri i studentëve aktivë është dukshëm më i ulët krahasuar me nivelin bachelor, duke u lëvizur rreth 5 mijë studentëve gjatë tre vjetëve të analizuar. Kjo reflekton vazhdimësinë e studimeve të ciklit të dytë dhe interesimin e studentëve për avancim akademik dhe profesional.

Ndërkaq, niveli i Doktoratës (PhD) përfshin një numër optimal studentësh, me rreth 140–190 studentë aktivë në vit. Megjithatë ky nivel ka përfaqësim më të kufizuar numerikisht, ai paraqet segmentin më të avancuar të studimeve dhe kërkimit shkencor në universitet.

Ne Universitetin e Prishtinës diplomojnë çdo vit rreth 4000 studentë, të cilët raportojnë në masë të madhe punësueshmëri të lartë, varësisht nga natyra e programit dhe kërkesat e tregut të punës.


Tabela 2. Numri i studentëve në të tri nivelet gjatë tre vjetëve të fundit



Kërkimi shkencor, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe infrastruktura

Sipas të dhënave të Scopus për Universitetin e Prishtinës, institucioni ka gjithsej 5,301 punime shkencore të indeksuara, të realizuara nga rreth 2,045 autorë, duke dëshmuar një bazë të gjerë të prodhimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik. Vetëm në pesë vjetët e fundit janë publikuar gjithsej 3,446 punime, që tregon një intensifikim të ndjeshëm të aktivitetit kërkimor dhe rritje të dukshme të pjesëmarrjes në publikime ndërkombëtare, me një trend përgjithësisht në rritje, pavarësisht luhatjeve vjetore në prodhimin shkencor. Gjatë pesë vjetëve të fundit, vërehet një rritje e vazhdueshme e trendit të publikimeve shkencore (shih grafikun 1.) duke reflektuar një rritje të përgjithshme të aktivitetit kërkimor në periudhën afatmesme, por edhe luhatje vjetore të ndikuara nga dinamika e projekteve kërkimore, publikimeve ndërkombëtare dhe faktorëve institucionalë të mbështetjes së publikimeve shkencore.

Grafiku 1. Trendi i publikimeve shkencore



Universiteti i Prishtinës është i përkushtuar ndaj bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë ndërkombëtar, me qëllim rritjen e cilësisë së përvijës akademike përmes mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik. Universiteti i Prishtinës ka ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi ndërkombëtar, duke nënshkruar rreth 250 memorandume mirëkuptimi (MoU) dhe marrëveshje bashkëpunimi me universitete, institute kërkimore, organizata ndërkombëtare dhe institucione publike në më shumë se 35 shtete të botës.

Këto partneritete shtrihen në Evropë, Amerikën e Veriut, Azi dhe rajonin e Ballkanit, me numrin më të madh të marrëveshjeve në Kosovë, Poloni, Shqipëri, Itali, Turqi, Hungari, SHBA dhe Gjermani. Marrëveshjet mbështesin shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik, zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, organizimin e konferencave dhe aktiviteteve shkencore, si dhe transferimin e njohurive dhe praktikave më të mira akademike. Ky rrjet bashkëpunimi dëshmon angazhimin e Universitetit të Prishtinës për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, forcimin e cilësisë akademike dhe rritjen e pjesëmarrjes në iniciativa ndërkombëtare të arsimit, kërkimit dhe inovacionit.

Këtë vit organizohet edicioni i 26-të i Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës, ku marrin pjesë numër i madh i studentëve ndërkombëtarë si dhe profesorëve nga mbarë bota.

Universiteti i Prishtinës është renditur në grupin 1501+ në rangimin ndërkombëtar *Times Higher Education*, duke reflektuar praninë dhe përfshirjen e tij në vlerësimet globale të institucioneve të arsimit të lartë në fushat e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Infrastruktura e Universitetit të Prishtinës paraqet një sistem të konsoliduar hapësirash akademike, kërkimore dhe mbështetëse, të shpërndara në disa kampuse dhe njësi akademike, duke reflektuar zhvillimin gradual institucional dhe rritjen e kapaciteteve për mësimdhënie, kërkim dhe shërbime studentore. Sipas të dhënave, universiteti operon në pesë lokacione kryesore dhe përfshin gjithsej 21 ndërtesa të njërive akademike dhe administratës, të cilat krijojnë bazën fizike për realizimin e veprimtarisë akademike dhe administrative.

Përveç funksionit arsimor, Universiteti i Prishtinës ka rol qendror në zhvillimin shkencor, kërkimin akademik dhe avancimin e kapitalit njerëzor në Kosovë. Ai përfaqëson institucionin kryesor publik për përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme si arsimit, mjekësia, inxhinieria, ekonomia, drejtësia, shkencat sociale dhe artet.

Gjatë periudhës 2020–2025, buxheti i Universitetit të Prishtinës ka mbetur relativisht i qëndrueshëm, duke u luhatur ndërmjet 31 dhe 35 milionë eurove, por duke pasur parasysh rritjen e inflacionit dhe kostove operative në vitet e fundit, veçanërisht pas vitit 2021, kjo rritje nominale nuk ka nënkuptuar domosdoshmërisht edhe një rritje reale të kapacitetit financiar, megjithëse rritja e buxhetit në vitin 2025 paraqet një përpjekje për të kompensuar pjesërisht efektet e inflacionit dhe nevojat në rritje të universitetit.

5.2. Konteksti institucional dhe zhvillimet në arsimin e lartë

Universiteti i Prishtinës (UP) vepron në një kontekst të transformimeve të vazhdueshme në arsimin e lartë, të karakterizuara nga rritja e kërkesave për cilësi, ndërkombëtarizim, digjitalizim, kërkim shkencor dhe llogaridhënie institucionale. Si institucioni më i madh i arsimit të lartë në Kosovë dhe një nga institucionet kryesore akademike në rajon, UP-

ja ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapitalit njerëzor, avancimin e dijes dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Zhvillimet globale dhe evropiane në arsimin e lartë po ndikojnë drejtpërdrejt edhe në universitetet e Kosovës. Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA), Procesi i Bolonjës dhe prioritetet e Bashkimit Evropian për arsimin, kërkimin dhe inovacionin kanë vendosur standarde të reja për funksionimin e universiteteve moderne. Në këtë kontekst, universitetet nuk vlerësohen më vetëm mbi bazën e ofrimit të programeve studimore, por edhe mbi performancën në kërkim shkencor, ndikimin shoqëror, ndërkombëtarizimin, integritetin akademik, transformimin digjital dhe kapacitetin për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve teknologjike.

Universiteti i Prishtinës ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit me këto zhvillime dhe standarde ndërkombëtare. Universiteti aktualisht ofron 140 programe studimore në të gjitha nivelet e studimit, përfshirë programe bachelor, master dhe doktoratë, duke mbuluar një spektër të gjerë disiplinash akademike. Në vitin 2025, universiteti kaloi procesin e riakreditimit institucional dhe akreditimit të programeve studimore, duke konfirmuar përputhshmërinë e tij me kërkesat kombëtare dhe standardet themelore të cilësisë në arsimin e lartë.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në nivel ndërkombëtar lidhet me forcimin e kulturës së sigurimit të cilësisë dhe orientimin drejt përmirësimit të vazhdueshëm institucional. Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015) kanë krijuar një kornizë të re për qeverisjen akademike, transparencën, përfshirjen e studentëve dhe përdorimin e evidencës në vendimmarrje. Në këtë drejtim, Universiteti i Prishtinës ka zhvilluar mekanizma institucionalë për vlerësimin e programeve studimore, monitorimin e performancës akademike dhe mbledhjen e feedback-ut nga studentët dhe stafi akademik. Megjithatë, zhvillimet ndërkombëtare kërkojnë kalimin nga një qasje formale e sigurimit të cilësisë drejt një kulture të integruar institucionale të cilësisë, ku të dhënat, analiza dhe rezultatet përdoren në mënyrë sistematike për planifikim strategjik dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) mbetet mekanizmi kryesor për vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë dhe gjatë viteve të fundit ka forcuar standardet e akreditimit në përputhje me Kornizën Evropiane të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë kontekst, Universiteti i Prishtinës ka rishikuar dhe harmonizuar rregulloret për akreditim dhe sigurim të cilësisë, duke forcuar sistemin e brendshëm të vlerësimit, përdorimin e të dhënave për përmirësim institucional dhe përfshirjen e palëve të interesit. Këto ndryshime e kanë bërë procesin e akreditimit më të bazuar në evidencë dhe kanë rritur përgjegjshmërinë institucionale, duke e pozicionuar UP-në më mirë në raport me kërkesat e AKA-së dhe standardet evropiane të cilësisë.

Një tjetër trend global që po transformon arsimin e lartë është digjitalizimi dhe zhvillimi i modeleve hibride të mësimdhënies dhe administrimit universitar. Përvoja pas pandemisë COVID-19 ka përshpejtuar integrimin e teknologjisë në universitetet në mbarë botën dhe ka rritur pritjet për fleksibilitet, qasje digjitale dhe shërbime inteligjente universitare. Universiteti i Prishtinës ka bërë progres të rëndësishëm përmes sistemit elektronik SEMS dhe përdorimit të platformave online në procese administrative dhe akademike. Megjithatë, standardet dhe praktikat ndërkombëtare po orientohen gjithnjë e më shumë drejt qeverisjes së bazuar në të dhëna (data-driven governance), përdorimit të inteligjencës artificiale, dashboard-eve institucionale dhe sistemeve të integruara për monitorimin e performancës dhe sigurimin e cilësisë. Këto

zhvillime kërkojnë investime të mëtejshme në infrastrukturë digjitale, kapacitete analitike dhe zhvillim profesional të stafit.

Në nivel ndërkombëtar, universitetet po përballen gjithashtu me kërkesa në rritje për ndërkombëtarizim të thelluar dhe integrim në rrjete globale akademike e kërkimore. Politikat evropiane dhe programet si Erasmus+, Horizon Europe dhe European Universities Initiative promovojnë bashkëpunimin ndëruniversitar, mobilitetin, programet e përbashkëta dhe kërkimin ndërdisiplinor. Universiteti i Prishtinës ka ruajtur pjesëmarrje aktive në programet Erasmus+ dhe projekte të tjera ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për mobilitet dhe ngritje profesionale të stafit dhe studentëve. Megjithatë, trendet ndërkombëtare tregojnë se ndërkombëtarizimi modern nuk kufizohet vetëm në mobilitet, por kërkon integrim më të thellë akademik përmes projekteve kërkimore, publikimeve të përbashkëta, programeve ndërkombëtare dhe përfshirjes në aleanca të ekselencës akademike.

Një prioritet tjetër në zhvillimet bashkëkohore të arsimit të lartë është lidhja më e fortë ndërmjet universiteteve dhe tregut të punës. Politikat evropiane për arsimin e lartë dhe aftësitë e së ardhmes kërkojnë që universitetet të zhvillojnë programe studimore të orientuara drejt kompetencave, inovacionit, ndërmarrësisë dhe aftësive digjitale. Në këtë drejtim, Universiteti i Prishtinës përballlet me nevojën për modernizim të vazhdueshëm të programeve studimore dhe forcim të bashkëpunimit me industrinë, institucionet publike dhe sektorin privat, në mënyrë që të rritet relevanca e studimeve dhe punësueshmëria e të diplomuarve.

Po ashtu, zhvillimet ndërkombëtare kanë rritur vëmendjen ndaj integritetit akademik, etikës në kërkim dhe transparencës institucionale. Universitetet moderne pritët të kenë politika të qarta kundër plagjiaturës, mekanizma për promovimin e etikës akademike dhe sisteme për garantimin e besueshmërisë së kërkimit shkencor. Universiteti i Prishtinës ka ndërmarrë hapa pozitivë në këtë drejtim përmes përdorimit të mjeteve antiplagjiaturë dhe forcimit të procedurave të vlerësimit akademik, por nevojitet zhvillim i mëtejshëm i kulturës institucionale të integritetit akademik dhe përgjegjësisë profesionale.

Në tërësi, Universiteti i Prishtinës ndodhet në një fazë të rëndësishme tranzicioni dhe konsolidimi institucional, ku zhvillimet ndërkombëtare në arsimin e lartë krijojnë njëkohësisht mundësi dhe presione për transformim të mëtejshëm. Standardet e reja të cilësisë, kërkesat për ndërkombëtarizim, digjitalizim, kërkim shkencor dhe qeverisje efektive kërkojnë një qasje më strategjike dhe të integruar ndaj zhvillimit institucional. Në këtë kontekst, periudha 2026–2030 paraqet një mundësi të rëndësishme për Universitetin e Prishtinës që të forcojë pozitën e tij si institucion lider akademik në vend dhe partner konkurrues në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

5.3. Analiza SWOT

Analiza SWOT e Universitetit të Prishtinës identifikon faktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin institucional të universitetit dhe shërben si bazë për formulimin e prioriteteve strategjike për periudhën 2026–2030. Analiza reflekton potencialin institucional të universitetit, sfidat organizative dhe akademike, si dhe mundësitë dhe rreziqet që burojnë nga zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Universiteti i Prishtinës gëzon pozitë qendrore në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë dhe ka bazë të konsoliduar institucionale, të mbështetur nga oferta e gjerë akademike, statusi i akreditimit institucional dhe mekanizmat ekzistues të sigurimit të cilësisë. Universiteti ofron programe studimore në të gjitha nivelet e studimit dhe ka ruajtur rol udhëheqës në zhvillimin akademik dhe shkencor në vend. Një ndër aspektet pozitive mbetet edhe funksionimi i mekanizmave formalë për sigurimin e cilësisë dhe baza ekzistuese për transformim digjital, përmes sistemit SEMS dhe përdorimit në rritje të shërbimeve online dhe mjeteve për integritet akademik. Universiteti ka ruajtur gjithashtu pjesëmarrje aktive në mobilitet dhe bashkëpunim ndërkombëtar, veçanërisht përmes programeve Erasmus+ dhe iniciativave të tjera ndërkombëtare.

Megjithatë, analiza eidenton edhe një sërë sfidash që kërkojnë adresim strategjik në periudhën e ardhshme. Performanca kërkimore dhe dukshmëria ndërkombëtare e universitetit mbeten ende të kufizuara krahasuar me universitetet më konkurruese në rajon dhe Evropë. Kompleksiteti organizativ dhe numri i madh i programeve studimore paraqesin sfida për standardizimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë. Proceset e akreditimit dhe kërkesat për sigurim të cilësisë kanë rritur nevojën për monitorim të vazhdueshëm të performancës dhe përdorim më sistematik të evidencës në vendimmarrje.

Në aspektin e transformimit digjital, universiteti ka krijuar bazë funksionale për digjitalizim, por nevojitet integrim më i avancuar i sistemeve dhe përdorimit strategjik të të dhënave institucionale për planifikim, monitorim dhe qeverisje. Po ashtu, ndërkombëtarizimi mbetet më i avancuar në aspektin e mobilitetit sesa në integrimin akademik dhe kërkimor, duke reflektuar nevojën për më shumë programe të përbashkëta, bashkëpunime kërkimore dhe përfshirje në rrjete ndërkombëtare të ekselencës. Një sfidë shtesë mbetet forcimi i lidhjes ndërmjet programeve studimore dhe tregut të punës, si dhe rritja e relevancës së programeve ndaj zhvillimeve ekonomike, teknologjike dhe profesionale.



Analiza identifikon gjithashtu mundësi të rëndësishme për zhvillim institucional gjatë periudhës 2026–2030. Riakreditimi institucional dhe statusi aktual i akreditimit krijojnë bazë të favorshme për reforma më të thella akademike dhe organizative. Programet Erasmus+, Horizon Europe dhe partneritetet ndërkombëtare ofrojnë mundësi për zhvillimin e stafit, laboratorëve, rrjeteve kërkimore dhe ndërkombëtarizimit të universitetit. Rritja e mundësive për mobilitet të brendshëm ndërmjet njësive akademike dhe mobilitet ndërkombëtar të studentëve dhe stafit krijon potencial për shkëmbim të dijes, ngritje profesionale dhe forcim të bashkëpunimit akademik. Transformimi digjital krijon potencial për zhvillimin e qeverisjes së bazuar në të dhëna, përdorimin e indikatorëve të performancës dhe avancimin e proceseve të monitorimit institucional. Ekziston po ashtu potencial për forcimin e mëtejshëm të kulturës së cilësisë, integritetit akademik dhe përfshirjes së studentëve në aktivitetet akademike dhe kërkimore. Universiteti ka mundësi të pozicionohet më fuqishëm si partner kombëtar për zhvillim dhe inovacion përmes bashkëpunimit me qeverinë, industrinë, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në të njëjtën kohë, universiteti përballlet me një sërë sfidash dhe presionesh të jashtme. Rritja e kërkesave rregullative dhe monitoruese krijon presion më të madh për evidencë, rezultate dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional. Konkurrenca rajonale dhe ndërkombëtare për studentë, staf akademik dhe projekte kërkimore po intensifikohet, duke rritur rrezikun e rënies relative të reputacionit dhe atraktivitetit institucional. Ekziston gjithashtu rreziku që transformimi digjital të mbetet fragmentar dhe i kufizuar kryesisht në procese administrative, pa integrim të plotë në qeverisje dhe sigurim të cilësisë.

Një sfidë tjetër mbetet ruajtja e balancës ndërmjet zgjerimit të ofertës akademike dhe ruajtjes së standardeve të cilësisë, si dhe shmangia e dallimeve të mundshme ndërmjet njësive akademike. Po ashtu, ekziston rreziku që mobiliteti ndërkombëtar të mos përkthehet në ndikim afatgjatë në kërkim, reforma institucionale dhe sigurim të financimit ndërkombëtar. Universiteti përballlet gjithashtu me rrezikun e humbjes së stafit dhe studentëve më të mirë drejt institucioneve më konkurruese në rajon dhe Evropë, si rezultat i konkurrencës së shtuar për talent dhe kapacitete akademike.

6. Korniza strategjike e Universitetit të Prishtinës 2026–2030

6.1. Vizioni

Vizioni i Universitetit të Prishtinës është të pozicionohet si universitet lider në rajon dhe partner i besueshëm në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, i njohur për ekselencë akademike, kërkim dhe inovacion me ndikim shoqëror, ndërkombëtarizim, transformim digjital dhe kontribut aktiv në zhvillimin demokratik dhe të qëndrueshëm të shoqërisë.

6.2. Misioni

Misioni i Universitetit të Prishtinës është të ofrojë arsimim dhe edukim akademik cilësor, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe shërbime për komunitetin dhe shoqërinë. Universiteti synon të funksionojë si qendër e ekselencës dhe inovacionit, duke bashkëvepruar me zhvillimet shoqërore dhe globale në funksion të zhvillimit të demokracisë, ekonomisë së vendit, konkurrueshmërisë ndërkombëtare dhe vlerave të një shoqërie demokratike dhe të qëndrueshme.

6.3. Vlerat dhe parimet strategjike

Universiteti i Prishtinës e zhvillon veprimtarinë e tij mbi bazën e vlerave dhe parimeve që udhëheqin zhvillimin akademik, institucional dhe shoqëror të universitetit.

Vlera / parimi	Përshkrimi
Ekselencia akademike	Promovimi i standardeve të larta në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe krijimtari akademike.
Integriteti dhe etika	Respektimi i integritetit akademik, transparencës, llogaridhënies dhe etikës profesionale.
Autonomia universitare	Mbrojtja e lirisë akademike dhe autonomisë institucionale në përputhje me standardet evropiane.
Studenti në qendër	Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe mbështetës për zhvillimin akademik dhe personal të studentëve.
Kërkimi dhe inovacioni	Nxitja e kërkimit shkencor, inovacionit dhe transferit të dijes në shërbim të shoqërisë.
Ndërkombëtarizimi	Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, mobilitetit akademik dhe integritit në rrjetet globale universitare.
Barazia dhe gjithëpërfshirja	Promovimi i diversitetit, mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit.
Transformimi digjital	Integrimi i teknologjive moderne dhe inteligjencës artificiale në proceset akademike dhe administrative.
Zhvillimi i qëndrueshëm	Promovimi i praktikave të qëndrueshme dhe përgjegjësisë sociale dhe mjedisore.
Ndikimi shoqëror dhe angazhimi qytetar	Promovimi i rolit aktiv të universitetit në zhvillimin demokratik, inovacionin social, bashkëpunimin me komunitetin dhe adresimin e sfidave shoqërore dhe globale.

6.4. Shtyllat strategjike dhe objektivat strategjike 2026–2030

Strategjia ndërtohet mbi gjashtë shtylla kryesore strategjike, të cilat synojnë forcimin e ekselencës akademike, avancimin e kërkimit dhe inovacionit, përmirësimin e përvojës studentore, thellimin e ndërkombëtarizimit, modernizimin e qeverisjes universitare dhe përsheptimin e transformimit digjital.

Shtylla strategjike	Objektivi strategjik
Shtylla strategjike 1 – Ekselencia akademike	Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i cilësisë dhe konkurrueshmërisë së programeve studimore sipas standardeve evropiane dhe kërkesave të tregut të punës.
Shtylla strategjike 2 – Përvoja studentore	Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i një mjedisi akademik me studentin në qendër, që ofron përvojë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për sukses akademik, zhvillim personal dhe punësueshmëri.
Shtylla strategjike 3 – Kërkimi dhe inovacioni	Objektivi strategjik 3: Fuqizimi i kapaciteteve kërkimore, inovacionit dhe transferit të dijes dhe teknologjisë për të rritur ndikimin akademik, shoqëror dhe ekonomik të Universitetit të Prishtinës.
Shtylla strategjike 4 – Ndërkombëtarizimi	Objektivi strategjik 4: Thellimi i ndërkombëtarizimit përmes zhvillimit të partneriteteve strategjike dhe bashkëpunimit akademik dhe kërkimor.
Shtylla strategjike 5 – Qeverisja dhe qëndrueshmëria	Objektivi strategjik 5: Konsolidimi i një sistemi bashkëkohor, transparent dhe të bazuar në performancë të qeverisjes universitare, me kulturë bashkëpunuese dhe qëndrueshmëri institucionale e financiare.
Shtylla strategjike 6 – Transformimi digjital	Objektivi strategjik 6: Përsheptimi i transformimit digjital dhe zhvillimi i një infrastrukture universitare moderne që mbështet mësimdhënien, kërkimin dhe vendimmarrjen.

6.4.1 Ekselencia akademike

Objektivi strategjik i kësaj shtylle është përmirësimi i cilësisë dhe konkurrueshmërisë së programeve studimore sipas standardeve evropiane dhe kërkesave të tregut të punës.

Kjo shtyllë strategjike fokusohet në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit në Universitetin e Prishtinës. Qëllimi është që këto programe të jenë moderne, konkurruese dhe në përputhje me standardet evropiane, duke reflektuar zhvillimet më të fundit shkencore dhe nevojat e tregut të punës.

Për ta arritur këtë, universiteti do të rishikojë dhe përditësojë rregullisht programet ekzistuese, si dhe do të zhvillojë programe të reja më fleksibile dhe inovative. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet përmirësimit të mësimdhënies, duke përdorur metoda më bashkëkohore dhe duke vendosur studentin në qendër të procesit mësimor. Në të

njëjtën kohë, do të forcohen programet e doktoratës dhe kërkimi shkencor, me synim rritjen e ndikimit akademik të universitetit.

Universiteti gjithashtu synon të hapet më shumë ndaj botës, duke ofruar më shumë programe në gjuhën angleze dhe duke tërhequr studentë ndërkombëtarë. Paralelisht, do të zhvillohen mundësi për mësim gjatë gjithë jetës përmes kurseve të shkurtra, mikro-kredencialeve dhe formave të tjera fleksibile të mësimi.

Objektivi strategjik 1	Përmirësimi i cilësisë dhe konkurrueshmërisë së programeve studimore sipas standardeve evropiane dhe kërkesave të tregut të punës.
Objektivat specifike	OS 1.1 – Përditësimi periodik i programeve studimore sipas standardeve të akreditimit, zhvillimeve shkencore dhe kërkesave të tregut të punës
	OS 1.2 – Zhvillimi i programeve inovative, fleksibile dhe ndërdisiplinore që adresojnë sfidat dhe nevojat e tregut
	OS 1.3 – Përmirësimi i mësimdhënies dhe vlerësimit përmes metodave moderne dhe qasjes së orientuar te studenti
	OS 1.4 – Fuqizimi i programeve të doktoratës përmes kërkimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar
	OS 1.5 – Rritja e programeve në gjuhën angleze për tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë dhe forcimin e ndërkombëtarizimit
	OS 1.6 – Fuqizimi i edukimit të vazhdueshëm dhe mikro-kredencialeve për të mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe tregun e punës

Objektivi specifik 1.1	Aktivitetet
Përditësimi periodik i programeve studimore sipas standardeve të akreditimit, zhvillimeve shkencore dhe kërkesave të tregut të punës	1.1.1 – Zhvillimi i kornizës rregullatore për përditësimin e programeve studimore
	1.1.2 – Monitorimi dhe raportimi i rregullt i progresit mbi përditësimin e programeve studimore
	1.1.3 – Digjitalizimi i proceseve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të brendshëm të programeve studimore

Objektivi specifik 1.2	Aktivitetet
Zhvillimi i programeve inovative, fleksibile dhe ndërdisiplinore që adresojnë sfidat dhe nevojat e tregut	1.2.1 – Hartimi i planit institucional për programe inovative, ndërdisiplinore, dhe programe për diploma të përbashkëta dhe të dyfishta
	1.2.2 – Zhvillimi dhe akreditimi i programeve inovative dhe ndërdisiplinore sipas planit institucional
	1.2.3 – Krijimi i hapësirave dhe laboratorëve inovativë për bashkëpunim ndërdisiplinor dhe punë praktike
	1.2.4 – Zhvillimi i programeve profesionale të orientuara në treg

Objektivi specifik 1.3	Aktivitetet
Përmirësimi i mësimdhënies dhe vlerësimit përmes metodave moderne dhe qasjes së orientuar të studentit	1.3.1 – Hartimi i planit për zhvillim profesional pedagogjik të personelit akademik
	1.3.2 – Organizimi i trajnimeve certifikuese për personelin akademik
	1.3.3 – Monitorimi i zbatimit të standardeve të vlerësimit të studentëve
	1.3.4 – Zhvillimi i moduleve trajnuese për avancimin e metodave moderne të mësimdhënies në kuadër të QPM-së
	1.3.5 – Hartimi i raporteve analitike mbi vlerësimin e studentëve për lëndët dhe mësimdhënien
	1.3.6 – Hartimi dhe zbatimi i masave për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e studentëve

Objektivi specifik 1.4	Aktivitetet
Fuqizimi i programeve të doktoratës përmes kërkimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar	1.4.1 – Zhvillimi i programeve të reja të doktoratës dhe ndërkombëtarizimi
	1.4.2 – Monitorimi i zbatimit të programeve të doktoratës
	1.4.3 – Ofrimi i programeve trajnuese për mentorim, mësimdhënien e bazuar në projekte dhe kërkime shkencore
	1.4.4 – Krijimi i mekanizmave për përfshirjen e studentëve të doktoratës në mësimdhënie, projekte dhe publikime shkencore

Objektivi specifik 1.5	Aktivitetet
Rritja e programeve në gjuhën angleze për tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë dhe forcimin e ndërkombëtarizimit	1.5.1 – Identifikimi i programeve me potencial ndërkombëtar
	1.5.2 – Zhvillimi dhe akreditimi i programeve të reja në gjuhën angleze
	1.5.3 – Përditësimi dhe zgjerimi i ofertës së lendeve në gjuhën angleze
	1.5.4 – Përditësimi i platformave informuese në disa gjuhë të huaja
	1.5.5 – Zhvillimi i skemave “Internationalization at Home”, bashkëpunimit virtual dhe ligjëratave online
	1.5.6 – Promovimi i programeve të reja

Objektivi specifik 1.6	Aktivitetet
Fuqizimi i edukimit të vazhdueshëm dhe mikro-kredencialeve për të mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe tregun e punës	1.6.1 – Hartimi i planit për edukim të vazhdueshëm dhe mikro-kredenciale
	1.6.2 – Zhvillimi i mikro-kredencialeve në fusha prioritare
	1.6.3 – Krijimi i kurseve të shkurtra dhe certifikimeve të orientuara drejt tregut të punës
	1.6.4 – Zhvillimi i platformës digjitale për mikro-kredenciale

Treguesit e performancës për objektivin strategjik 1

Treguesi kryesor (KPI)	Synimi 2030
% e programeve studimore të rishikuara dhe harmonizuara me standardet ESG/EQF dhe kërkesat e tregut të punës	100% e programeve të rishikohen brenda ciklit 3–5 vjeçar
Numri i programeve inovative, ndërdisiplinare dhe ndërkombëtare (joint/dual degree dhe programe në gjuhën angleze)	≥ 15 programe të reja
% e stafit akademik të trajnuar/certifikuar në pedagogji moderne, metoda digjitale dhe mësimdhënie të orientuar te studenti	≥ 80% e stafit akademik

6.4.2 Përvoja studentore

Objektivi strategjik i kësaj shtylle është zhvillimi i një mjedisi akademik me studentin në qendër, që ofron përvojë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për sukses akademik, zhvillim personal dhe punësueshmëri.

Kjo shtyllë strategjike synon të vendosë studentin në qendër të të gjitha proceseve në Universitetin e Prishtinës, duke ofruar një përvojë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse që kontribuon në suksesin akademik, zhvillimin personal dhe përgatitjen për tregun e punës.

Universiteti do të përmirësojë shërbimet studentore, këshillimin akademik dhe mbështetjen digjitale, si dhe do të forcojë mekanizmat e mbështetjes përmes mentorimit, karrierës dhe mirëqenies. Po ashtu, do të rrisë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje dhe sigurimin e cilësisë, duke promovuar transparencë dhe bashkëpunim.

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet barazisë dhe gjithëpërfshirjes, si dhe lidhjes së studimeve me tregun e punës përmes praktikave dhe bashkëpunimit me industrinë. Monitorimi i karrierës së të diplomuarve do të ndihmojë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve studimore dhe rritjen e punësueshmërisë së studentëve.

Objektivi strategjik 2	Zhvillimi i një mjedisi akademik me studentin në qendër, që ofron përvojë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për sukses akademik, zhvillim personal dhe punësueshmëri.
Objektivat specifike	OS 2.1 – Përmirësimi i shërbimeve studentore përmes zhvillimit administrativ, këshillimit dhe mbështetjes digjitale
	OS 2.2 – Zhvillimi i mekanizmave të mbështetjes akademike, profesionale dhe të mirëqenies për studentët
	OS 2.3 – Rritja e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje dhe cilësi
	OS 2.4 – Sigurimi i barazisë dhe përfshirjes në arsim për të gjithë studentët
	OS 2.5 – Forcimi i lidhjes ndërmjet studimeve, praktikës profesionale dhe punësueshmërisë

	OS 2.6 – Zhvillimi i sistemit për monitorimin e karrierës së të diplomuarve për përmirësim të punësueshmërisë dhe programeve
--	---

Objektivi specifik 2.1	Aktivitetet
Përmirësimi i shërbimeve studentore përmes zhvillimit administrativ, këshillimit dhe mbështetjes digjitale	2.1.1 – Analizimi i gjendjes dhe nevojave për përmirësimin e shërbimeve studentore 2.1.2 – Zhvillimi i platformës për menaxhimin e shërbimeve studentore 2.1.3 – Krijimi i sistemit “One-Stop-Shop” për shërbime studentore 2.1.4 – Zhvillimi i sistemit të asistencës (<i>Help Desk</i>) dhe mbështetjes digjitale për studentët 2.1.5 – Sigurimi i qasjes në burime akademike digjitale ndërkombëtare 2.1.6 – Krijimi dhe përmirësimi i hapësirave për mësim, bashkëpunim dhe rekreacion studentor në kampus

Objektivi specifik 2.2	Aktivitetet
Zhvillimi i mekanizmave të mbështetjes akademike, profesionale dhe të mirëqenies për studentët	2.2.1 – Ofrimi i mbështetjes akademike përmes tutorimit dhe mësimit bashkëmoshatar (“peer learning”) 2.2.2 – Ofrimi i shërbimeve të këshillimit në karrierë 2.2.3 – Organizimi i eventeve me alumni dhe industrinë 2.2.4 – Themelimi i Qendrës për mbështetje psikologjike, sociale dhe akademike 2.2.5 – Zhvillimi i hapësirave dhe programeve për aktivitete sportive, kulturore dhe artistike 2.2.6 – Krijimi i kantinave për studentët brenda NJA-ve 2.2.7 – Institucionalizimi i ceremonisë së diplomimit në nivel universitar si mekanizëm për promovimin e suksesit studentor, forcimin e identitetit institucional dhe zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin e alumni-ve

Objektivi specifik 2.3	Aktivitetet
Rritja e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje dhe sigurimin e cilësisë	2.3.1 – Analizimi i mekanizmave aktual të përfaqësimit të studentëve në vendimmarrje 2.3.2 – Organizimi i forumeve të rregullta konsultative me studentët në nivel të NJA-ve dhe departamenteve 2.3.3 – Zhvillimi i mekanizmave digjitalë për sugjerime, ankesa dhe feedback të studentëve 2.3.4 – Themelimi i klubeve profesionale studentore. 2.3.5 – Funkcionalizimi i revistës studentore

Objektivi specifik 2.4	Aktivitetet
Sigurimi i barazisë dhe përfshirjes në arsim për të gjithë studentët	2.4.1 – Zhvillimi i politikave për barazi dhe diversitet 2.4.2 – Vlerësimi i nivelit të qasshmërisë fizike dhe digjitale në NJA dhe njësitë e UP-së

	2.4.3 – Hartimi i planit të aksesueshmërisë
	2.4.4 – Trajnimi i stafit akademik dhe administrativ për barazi, diversitet dhe gjithëpërfshirje
	2.4.5 – Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese për parandalimin dhe raportimin e diskriminimit dhe ngacmimeve
	2.4.6 – Hartimi i rregulloreve mbi parandalimin e konfliktit të interesit
	2.4.7 – Monitorimi i zbatimit të politikave të barazisë dhe përfshirjes

Objektivi specifik 2.5	Aktivitetet
Forcimi i lidhjes ndërmjet studimeve, praktikës profesionale dhe punësueshmërisë	2.5.1 – Analiza e nivelit të punësueshmërisë për programe studimore, fakultete dhe UP
	2.5.2 – Nënshkrimi i marrëveshjeve me korporata/oda/borde/ shoqata për zhvillim të shkathtësive praktike të studentëve për secilin program
	2.5.3 – Ofrimi i praktikave profesionale sipas programeve studimore të ndërlidhura me industri
	2.5.4 – Organizimi i panairove të karrierës dhe aktiviteteve të rrjetëzimit profesional
	2.5.5 – Përfshirja e profesionistëve të industrisë në ligjërime
	2.5.6 – Zhvillimi i sistemit për mentorimin dhe monitorimin e praktikave profesionale
	2.5.7 – Kryerja e praktikave profesionale jashtëkurrikulare në institucione publike dhe private

Objektivi specifik 2.6	Aktivitetet
Zhvillimi i sistemit për monitorimin e karrierës së të diplomuarve për përmirësim të punësueshmërisë dhe programeve	2.6.1 – Përditësimi i databazës së të diplomuarve (Alumni UP)
	2.6.2 – Hartimi dhe publikimi i raportit për shkallën e punësueshmërisë dhe përgatitjes për treg të punës
	2.6.3 – Zbatimi i anketave periodike me të diplomuarit dhe punëdhënësit nga të gjitha NJA-të
	2.6.4 – Përditësimi i statusit të shoqatës " Alumni UP"
	2.6.5 – Integrimi i feedback-ut të të diplomuarve në përmirësimin e programeve të studimit

Treguesit e performancës për objektivin strategjik 2

Treguesi kryesor (KPI)	Synimi 2030
Niveli i kënaqshmërisë së studentëve me shërbimet administrative, akademike dhe mbështetëse	≥ 80% kënaqshmëri
% e studentëve të përfshirë në praktika profesionale, mentorim, shërbime karriere dhe aktivitete mbështetëse	≥ 80% e studentëve
% e të diplomuarve të punësuar ose të angazhuar në studime të mëtejshme brenda 12 muajve pas diplomimit	≥ 70%

6.4.3 Kërkimi dhe inovacioni

Objektivi strategjik i kësaj shtylle është fuqizimi i kapaciteteve kërkimore, inovacionit dhe transferit të dijes dhe teknologjisë për të rritur ndikimin akademik, shoqëror dhe ekonomik të Universitetit të Prishtinës.

Kjo shtyllë strategjike synon ta pozicionojë Universitetin e Prishtinës si një institucion modern kërkimor dhe inovativ, me ndikim të matshëm akademik, shoqëror dhe ndërkombëtar. Përmes kërkimit shkencor dhe inovacionit, universiteti synon të kontribuojë në avancimin e dijes, adresimin e sfidave shoqërore dhe globale, si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Universiteti do të forcojë kapacitetet kërkimore, do të rrisë pjesëmarrjen në projekte konkurruese dhe do të modernizojë infrastrukturën. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet kërkimit ndërdisiplinor dhe përfshirjes së studentëve në aktivitete kërkimore.

Po ashtu, synohet rritja e cilësisë dhe dukshmërisë së publikimeve shkencore, zhvillimi i inovacionit dhe transferit të teknologjisë, si dhe forcimi i bashkëpunimit me industrinë, institucionet publike, komunitetin dhe partnerët ndërkombëtarë. Në të njëjtën kohë, universiteti do të promovojë shkencën e hapur, etikën në kërkim, menaxhimin e të dhënave dhe kontributin e kërkimit shkencor në zhvillimin e politikave publike dhe adresimin e sfidave të shoqërisë.

Objektivi strategjik 3	Fuqizimi i kapaciteteve kërkimore, inovacionit dhe transferit të dijes dhe teknologjisë për të rritur ndikimin akademik, shoqëror dhe ekonomik të Universitetit të Prishtinës.
Objektivat specifike	OS 3.1 – Forcimi i qeverisjes dhe ngritja e kapaciteteve institucionale për kërkim
	OS 3.2 – Forcimi i kapaciteteve njerëzore në kërkim
	OS 3.3 – Modernizimi i infrastrukturës kërkimore dhe përdorimi i përbashkët
	OS 3.4 – Promovimi i kërkimit ndërdisiplinor dhe përfshirja e studentëve
	OS 3.5 – Rritja e publikimeve shkencore dhe e performancës akademike
	OS 3.6 – Zhvillimi i inovacionit, transferit të teknologjisë dhe komercializimit
	OS 3.7 – Forcimi i partneriteteve kombëtare, ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit me industrinë dhe rritja e ndikimit në shoqëri
	OS 3.8 – Zhvillimi i politikave dhe praktikave për shkencë të hapur, etikë në kërkim dhe menaxhim të të dhënave

Objektivi specifik 3.1	Aktivitetet
Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave, sistemeve dhe rregulloreve që sigurojnë planifikim, koordinim, monitorim dhe llogaridhënie në kërkim	3.1.1 – Funksionalizimi i plotë i Zyrës për Projekte të Sponsorizuara
	3.1.2 – Themelimi dhe funksionalizimi i Zyrës për Transfer të Teknologjisë (TTO)
	3.1.3 – Hartimi i politikave për kërkim, pronësi intelektuale, qasje të hapur, etikë në kërkime dhe menaxhim të të dhënave
	3.1.4 – Krijimi i grupeve kërkimore bërthamë në fakultete dhe atyre ndërdisiplinare mes departamenteve dhe/ose fakulteteve
	3.1.5 – Ngritja e kapaciteteve administrative të zyrës kërkimore përmes trajnimeve dhe rekrutimit të personelit të specializuar
	3.1.6 – Hartimi i planit vjetor institucional të kërkimit, me objektiva të matshme dhe raportim periodik
	3.1.7 – Ngritja e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm të aktiviteteve kërkimore

Objektivi specifik 3.2	Aktivitetet
Zhvillimi i stafit akademik, doktorantëve, post-doktorantëve dhe diasporës akademike si bazë për rritjen e cilësisë kërkimore	3.2.1 – Skema të incentivimit dhe njohjes akademike për stafin aktiv në kërkim
	3.2.2 – Trajnime për metodologji kërkimore, aplikim dhe menaxhim grantesh
	3.2.3 – Mbështetje financiare dhe akademike për doktorantë dhe postdoktorantë
	3.2.4 – Punësimi i stafit të specializuar (hulumtues/laborant) për përdorim të infrastrukturës shkencore
	3.2.5 – Program për aktivizimin e diasporës akademike përmes vizitave, bashkëpunimeve dhe projekteve të përbashkëta
	3.2.6 – Incentivim për rritje të mobilitetit dhe qëndrimeve kërkimore ndërkombëtare për stafin akademik
	3.2.7 – Ngritja e programeve mentorimi për stafin e ri akademik
	3.2.8 – Promovimi i skemave për lejen kërkimore (pushim sabbatike) për stafin akademik me arritje të larta shkencore

	3.2.9 – Integrimi i kompetencave kërkimore në kriteret e rekrutimit dhe avancimit të stafit akademik
--	---

Objektivi specifik 3.3	Aktivitetet
Modernizimi dhe menaxhimi efikas i infrastrukturës kërkimore, me fokus në auditim, digjitalizim, akreditim dhe përdorim të përbashkët	3.3.1 – Inventarizimi dhe digjitalizimi (krijimi i bazave të të dhënave) për infrastrukturën kërkimore
	3.3.2 – Fuqizimi i instituteve dhe modernizim i laboratorëve ekzistues sipas standardeve ndërkombëtare
	3.3.3 – Zbatim i modelit të përdorimit të përbashkët të infrastrukturës ndërmjet njësive akademike
	3.3.4 – Promovimi i përdorimit të hapur të infrastrukturës shkencore edhe për partnerë të jashtëm
	3.3.5 – Krijim i qendrave ndërdisiplinore të ekselencës me fokus në fushat prioritare
	3.3.6 – Sigurimi i financimit për mirëmbajtje dhe pajisje të laboratorëve ekzistues dhe të rinj
	3.3.7 – Akreditimi i laboratorëve sipas standardeve ndërkombëtare (ISO dhe standarde të tjera relevante)

Objektivi specifik 3.4	Aktivitetet
Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet njësive akademike dhe integrimi i studentëve në aktivitete kërkimore	3.4.1 – Promovimi i kërkimit ndërdisiplinor përmes fondeve dhe strukturave mbështetëse institucionale
	3.4.2 – Përfshirja e studentëve (BA/MA/PhD) në projekte kërkimore aktive
	3.4.3 – Integrimi i kërkimit në mësimdhënie përmes kurseve të bazuara në hulumtim
	3.4.4 – Mbështetja e organizimit të konferencave dhe aktiviteteve kërkimore studentore
	3.4.5 – Zhvillimi i kulturës kërkimore institucionale përmes ngjarjeve, çmimeve dhe njohjes publike
	3.4.6 – Promovimi i mobilitetit kërkimor për studentët me fokus në praktikat kërkimore

Objektivi specifik 3.5	Aktivitetet
Rritja e numrit, cilësisë dhe ndikimit të publikimeve shkencore,	3.5.1 – Rishikimi i politikave dhe targeteve institucionale për publikim shkencor

duke forcuar mekanizmat mbështetës dhe dukshmërinë akademike	3.5.2 – Incentivimi - krijimi i fondit për mbështetje të publikimeve shkencore në platforma dhe revista kredibile ndërkombëtare
	3.5.3 – Trajnime për shkrim shkencor dhe publikim në revista ndërkombëtare
	3.5.4 – Rritja e dukshmërisë shkencore së publikimeve të stafit (përditësim i profileve të stafit në ueb-in e UP-së, ORCID, Scopus, WoS)
	3.5.5 – Rritja e qasjes në revista dhe burime shkencore ndërkombëtare
	3.5.6 – Ngritja e sistemit të monitorimit periodik të performancës publike sipas njësive akademike
	3.5.7 – Vendosja e stimuljeve specifike për publikime në revista Q1/Q2 sipas Scopus/WoS

Objektivi specifik 3.6	Aktivitetet
Krijimi i mekanizmave institucionale për menaxhimin e pronësisë intelektuale, komercializimin e rezultateve dhe mbështetjen e <i>start-up/spin-off</i>	3.6.1 – Zhvillimi dhe implementimi i programeve për transfer të teknologjisë nga universiteti drejt industrisë
	3.6.2 – Krijimi i programeve për mbështetje e spin-off-eve dhe start-up-eve universitare përmes mentorimit dhe financimit fillestar
	3.6.3 – Forcimi i bashkëpunimit me industrinë përmes marrëveshjeve dhe projekteve të përbashkëta kërkimore
	3.6.4 – Ngritja e inkubatorit të inovacionit universitar si hapësirë mbështetëse për ndërmarrjet e reja bazuara në dije
	3.6.5 – Organizimi i eventeve për transfer të teknologjisë dhe inovacionit (hackathons dhe sfida inovacioni)

Objektivi specifik 3.7	Aktivitetet
Forcimi i bashkëpunimit me universitetet, industrinë, sektorin publik, komunitetin dhe rrjetet ndërkombëtare	3.7.1 – Partneritete strategjike dhe anëtarësim në rrjete dhe aleanca kërkimore ndërkombëtare
	3.7.2 – Krijimi i platformës "Shkenca për shoqërinë" për komunikim të rezultateve kërkimore me publikun e gjerë
	3.7.3 – Incentivim për rritje të aplikimeve në Horizon Europe, Erasmus+, COST Action dhe programe të tjera ndërkombëtare

	3.7.4 – Rritja e projekteve të përbashkëta me institucionet publike dhe private kombëtare
	3.7.5 – Zhvillimi i projekteve që implementohen në komunitet dhe me përfshirje të qytetarëve (Citizen Science)
	3.7.6 – Zhvillimi i projekteve për shëndetin dhe mirëqenien e komunitetit në partneritet me institucione publike
	3.7.7 – Programe doktorale të përbashkëta me universitete partnere ndërkombëtare
	3.7.8 – Zhvillimi i programeve duale me sektorin profesional dhe industrial
	3.7.9 – Ngritja e një mekanizmi të rregullt komunikimi dhe raportimi publik mbi ndikimin shoqëror të kërkimit universitar

Objektivi specifik 3.8	Aktivitetet
Zbatimi i standardeve institucionale për shkencë të hapur, etikë kërkimore, integritet akademik dhe menaxhim të përgjegjshëm të të dhënave	3.8.1 – Zhvillimi i politikave institucionale për shkencë të hapur dhe të dhëna të hapura
	3.8.2 – Dizajnimi dhe funksionalizimi i repositoreve institucional për publikime shkencore
	3.8.3 – Zbatimi i planeve të menaxhimit të të dhënave (Data Management Plans - DMP) në të gjitha projektet kërkimore
	3.8.4 – Monitorimi i mekanizmave mbikëqyrës për etikën kërkimore dhe integritetin akademik
	3.8.5 – Ofrimi i trajnimeve të rregullta për Open Science dhe etikë kërkimore për stafin dhe doktorantët
	3.8.6 – Harmonizimi i rregulloreve institucionale me GDPR për mbrojtjen e të dhënave personale në kërkim
	3.8.7 – Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse mbi kulturën e shkencës së hapur brenda komunitetit akademik

Treguesit e performancës për objektivin strategjik 3

Treguesi kryesor (KPI)	Synimi 2030
Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtarisht dhe publikimeve me bashkautorë ndërkombëtarë	≥ Dyfishim krahasuar me vitin bazë
Numri i projekteve kërkimore, partneriteteve ndërkombëtare dhe fondeve të fituara për kërkim dhe inovacion	≥ 100 iniciativa/projekte aktive
Numri i grupeve kërkimore, qendrave ndërdisiplinore dhe iniciativave për transfer të teknologjisë dhe inovacion	≥ 20 iniciativa aktive

6.4.4 Ndërkombëtarizimi

Objektivi strategjik i kësaj shtylle është thellimi i ndërkombëtarizimit përmes zhvillimit të partneriteteve strategjike dhe bashkëpunimit akademik dhe kërkimor.

Kjo shtyllë strategjike synon të forcojë integrimin e Universitetit të Prishtinës në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, duke rritur cilësinë, konkurrueshmërinë, reputacionin dhe ndikimin e tij ndërkombëtar.

Universiteti do të rrisë mobilitetin e studentëve dhe stafit, do të zhvillojë partneritete strategjike afatgjata me universitete dhe institucione ndërkombëtare, si dhe do të zgjerojë pjesëmarrjen në iniciativa, rrjete dhe programe evropiane dhe globale. Po ashtu, do të promovojë zhvillimin e programeve të përbashkëta, diplomave të dyfishta dhe aktiviteteve të tjera akademike që forcojnë dimensionin ndërkombëtar të mësimdhënies dhe kërkimit.

Një fokus i veçantë do t'i kushtohet angazhimit të diasporës akademike dhe rrjeteve të alumni-ve si urë bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, si dhe promovimit të diplomacisë akademike përmes partneriteteve strategjike dhe shkëmbimit të njohurive. Paralelisht, ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor dhe programeve të doktoratës do të kontribuojë në rritjen e dukshmërisë dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare të universitetit.

Përmes këtyre veprimeve, Universiteti i Prishtinës synon të konsolidojë pozitën e tij si partner i besueshëm në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe kërkimit, duke forcuar reputacionin institucional dhe praninë e tij në nivel ndërkombëtar.

Objektivi strategjik 4	Thellimi i ndërkombëtarizimit përmes zhvillimit të partneriteteve strategjike dhe bashkëpunimit akademik dhe kërkimor.
Objektivat specifike	OS 4.1 – Rritja e mobilitetit ndërkombëtar
	OS 4.2 – Zhvillimi i partneriteteve strategjike ndërkombëtare
	OS 4.3 – Zgjerimi i programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta
	OS 4.4 – Përfshirja e diasporës akademike
	OS 4.5 – Pjesëmarrja në rrjete dhe projekte ndërkombëtare
	OS 4.6 – Ndërkombëtarizimi i kërkimit dhe programeve të doktoratës

Objektivi specifik 4.1	Aktivitetet
Rritja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit	4.1.1 – Organizimi i fushatave informuese dhe promovuese për mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar
	4.1.2 – Hartimi i planeve të mobilitetit në nivel të NJA-ve
	4.1.3 – Harmonizimi i procedurave dhe rregulloreve për njohjen e kredive dhe lëndëve nga mobiliteti ndërkombëtar
	4.1.4 – Njohja e mobiliteteve të personelit akademik në kartelën e performancës
	4.1.5 – Monitorimi i zbatimit të planeve të mobiliteteve
	4.1.6 – Krijimi i programit “Student Ambassadors” për promovimin e mobilitetit dhe ndërkombëtarizimit
	4.1.7 – Zhvillimi i strategjisë për reputacion institucional, komunikim strategjik dhe branding ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës

Objektivi specifik 4.2	Aktivitetet
	4.2.1 – Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me partnerët strategjikë ndërkombëtar
	4.2.2 – Angazhimi i NJA-ve në konsorciume dhe projekte ndërkombëtare
	4.2.3 – Zgjerimi i pjesëmarrjes së UP-së në rrjete dhe iniciativa ndërkombëtare akademike dhe kërkimore
	4.2.4 – Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare (Universiteti Veror, Shkolla Dimërore, ligjërata të hapura, përfshirja e diasporës akademike)
	4.2.5 – Krijimi i bazës së të dhënave për monitorimin e partneriteteve

Objektivi specifik 4.3	Aktivitetet
Zgjerimi i programeve të përbashkëta, diplomave të dyfishta dhe bashkëpunimeve akademike ndërkombëtare	4.3.1 – Zhvillimi i programeve Master me diploma të dyfishta/ të përbashkëta
	4.3.2 – Zhvillimi i programeve doktorale me diploma të dyfishta/ të përbashkëta
	4.3.3 – Zhvillimi i bashkë-udhëheqjes ndërkombëtare të doktoratave
	4.3.4 – Përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë në programe doktorale dhe kërkim shkencor
	4.3.5 – Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të programeve të përbashkëta

Objektivi specifik 4.4	Aktivitetet
Rritja e përfshirjes së diasporës akademike në mësimdhënie, kërkim dhe mentorim	4.4.1 – Krijimi i databazës së diasporës akademike
	4.4.2 – Zhvillimi i planit për përfshirjen e profesorëve vizitorë
	4.4.3 – Organizimi i ligjëratave dhe aktiviteteve akademike

	4.4.4 – Përfshirja e profesorëve ndërkombëtar dhe diasporës akademike në mentorim, kërkim dhe publikime shkencore.
	4.4.5 – Zhvillimi i kurrikulave me përfshirjen e diasporës akademike

Objektivi specifik 4.5	Aktivitetet
Rritja e përfshirjes në projekte ndërkombëtare	4.5.1 – Trajnimi i stafit akademik dhe administrativ për aplikim dhe menaxhim të projekteve ndërkombëtare
	4.5.2 – Organizimi i aktiviteteve për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira nga projektet ndërkombëtare
	4.5.3 – Zhvillimi i databazës për monitorimin e projekteve ndërkombëtare dhe përfshirjes së stafit dhe studentëve
	4.5.4 – Krijimi i databazës për projektet ndërkombëtare.

Treguesit e performancës për objektivin strategjik 4

Treguesi kryesor (KPI)	Synimi 2030
Numri i programeve të përbashkëta, diplomave të dyfishta dhe programeve doktorale me bashkëpunim ndërkombëtar	≥ 10 programe
Numri i projekteve, publikimeve dhe partneriteteve strategjike ndërkombëtare aktive	≥ 100 iniciativa aktive
Numri i ekspertëve dhe profesorëve nga diaspora akademike të angazhuar në mësimdhënie, mentorim, kërkim dhe aktivitete akademike	≥ 100 ekspertë aktivë

6.4.5 Qeverisja dhe qëndrueshmëria

Objektivi strategjik i kësaj shtylle është konsolidimi i një sistemi bashkëkohor, transparent dhe të bazuar në performancë të qeverisjes universitare, me kulturë bashkëpunuese dhe qëndrueshmëri institucionale e financiare.

Kjo shtyllë strategjike synon të forcojë një sistem modern, efikas dhe të përgjegjshëm të qeverisjes universitare, të bazuar në transparencë, llogaridhënie, performancë dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë. Universiteti do të promovojë modele bashkëkohore të menaxhimit institucional që mbështesin cilësinë, inovacionin, fleksibilitetin organizativ dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Universiteti do të modernizojë proceset e qeverisjes dhe menaxhimit përmes përdorimit të teknologjive të reja, zhvillimit të sistemeve të avancuara të monitorimit të performancës dhe zbatimit të praktikave të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet forcimit të planifikimit strategjik, monitorimit të rezultateve dhe zhvillimit të mekanizmave të llogaridhënies institucionale.

Po ashtu, do të forcohet menaxhimi i burimeve njerëzore përmes zhvillimit profesional, mbështetjes së stafit të ri akademik, mekanizmave transparentë të vlerësimit dhe avancimit, si dhe iniciativave për tërheqjen dhe mbajtjen e stafit cilësor, përfshirë angazhimin e diasporës akademike dhe promovimin e politikave të “brain gain”.

Paralelisht, universiteti do të promovojë një kulturë organizative të bazuar në integritet, bashkëpunim, përgjegjësi dhe përmirësim të vazhdueshëm. Në këtë kuadër, do të forcohen kapacitetet për menaxhimin e rrezikut institucional, përfshirë rreziqet financiare, demografike, teknologjike dhe të sigurisë kibernetike, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe aftësisë së universitetit për t’iu përshtatur ndryshimeve dhe sfidave të ardhshme.

Objektivi strategjik 5	Konsolidimi i një sistemi bashkëkohor, transparent dhe të bazuar në performancë të qeverisjes universitare, me kulturë bashkëpunuese dhe qëndrueshmëri institucionale e financiare.
Objektivat specifikë	OS 5.1 – Fuqizimi i qeverisjes institucionale
	OS 5.2 – Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të performancës të bazuar në indikatorë dhe monitorim të vazhdueshëm
	OS 5.3 – Shfrytëzimi efektiv i burimeve njerëzore përmes zhvillimit profesional të stafit
	OS 5.4 – Fuqizimi i kulturës organizative i bazuar në bashkëpunim, llogaridhënie dhe integritet
	OS 5.5 – Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare

Objektivi specifik OS 5.1	Aktivitetet
Fuqizimi i qeverisjes institucionale	5.1.1 – Hartimi i analizës mbi strukturën organizative, rolet, proceset e vendimmarrjes dhe koordinimit ndërmjet njësive të UP-së
	5.1.2 – Hartimi i rregullores dhe udhëzuesit për përdorimin e inteligjencës artificiale (AI)
	5.1.3 – Hartimi i politikave për Universitetin e Gjelbër (<i>Green Campus</i>)
	5.1.4 – Funksionalizimi i Gazetës Zyrtare të UP-së
	5.1.5 – Hartimi i Strategjisë së Komunikimit dhe Promovimit Institucional
	5.1.6 – Implementimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë
	5.1.7 – Hartimi i udhëzuesit institucional (<i>roadmap</i>) për zhvillim të qëndrueshëm dhe tranzicion të gjelbër në Universitetin e Prishtinës

Objektivi specifik 5.2	Aktivitetet
Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të performancës të bazuar në indikatorë dhe monitorim të vazhdueshëm	5.2.1 – Hartimi i kornizës rregullative për vlerësimin e performancës
	5.2.2 – Krijimi i mekanizmave për implementimin e rregullores për vlerësimin e performancës së personelit akademik

	5.2.3 - Hartimi i udhëzuesit për ngritjen e pozicionimit ndërkombëtar
	5.2.4 – Digjitalizimi i sistemit të monitorimit të performancës

Objektivi specifik 5.3	Aktivitetet
Shfrytëzimi efektiv i burimeve njerëzore përmes zhvillimit profesional të stafit	5.3.1 – Rishikimi i rregullores për vlerësimin, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës
	5.3.2 – Zhvillimi i programeve të trajnimit dhe zhvillimit të stafit administrativ
	5.3.3 – Hartimi i planit strategjik 5-vjeçar të rekrutimit
	5.3.4 – Implementimi i vlerësimit të performancës së stafit
	5.3.5 – Zhvillimi i planeve individuale të karrierës
	5.3.6 – Themelimi i mekanizmave për motivimin dhe mbajtjen e stafit
	5.3.7 - Zhvillimi i mekanizmave për tërheqjen, zhvillimin dhe mbajtjen e stafit cilësor akademik, përfshirë bashkëpunimin me diasporën akademike dhe iniciativat për “brain gain”
	5.3.8 - Zhvillimi i kornizës institucionale për menaxhimin e rrezikut, përfshirë rreziqet financiare, demografike, teknologjike dhe të sigurisë kibernetike

Objektivi specifik 5.4	Aktivitetet
Fuqizimi i kulturës organizative i bazuar në bashkëpunim, llogaridhënie dhe integritet	5.4.1 – Hartimi i planit të integritetit institucional
	5.4.2 – Forcimi i llogaridhënies dhe transparencës përmes raportimit të rregullt
	5.4.3 – Organizimi i trajnimeve për lidhshmëri dhe menaxhment
	5.4.4 – Krijimi i forumeve, rrjeteve dhe aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet stafit universitar
	5.4.5 – Hartimi i kodeve të etikës për personelin akademik, administrativ dhe studentët
	5.4.5 - Integrimi gradual i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe aktivitete institucionale

Objektivi specifik 5.5	Aktivitetet
Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare	5.5.1 – Hartimi i rregullores për pranimin dhe menaxhimin transparent të donacioneve
	5.5.2 – Rritja e financimit nga programe ndërkombëtare
	5.5.3 – Gjenerimi i të hyrave përmes ofrimit të shërbimeve të konsulencës nga institutet dhe qendrat
	5.5.4 – Krijimi i sistemeve financiare për inovacion
	5.5.5 – Hartimi dhe zbatimi i planit për kampus të gjelbër, me fokus në efikasitet energjetik, menaxhim të mbeturinave dhe praktika të qëndrueshme institucionale

Treguesit e performancës për objektivin strategjik 5

Treguesi kryesor (KPI)	Synimi 2030
% e proceseve institucionale dhe sistemeve të menaxhimit të digjitalizuara dhe të standardizuara	≥ 80%
% e stafit akademik dhe administrativ të përfshirë në vlerësim të performancës dhe zhvillim profesional	≥ 100%
% e rritjes së financimit nga projekte ndërkombëtare, donacione dhe shërbime të gjenerimit të të hyrave	≥ 50% rritje krahasuar me vitin bazë

6.4.6 Transformimi digjital

Objektivi strategjik i kësaj shtylle është përshpejtimi i transformimit digjital dhe zhvillimi i një infrastrukture universitare moderne që mbështet mësimdhënien, kërkimin dhe vendimmarrjen.

Kjo shtyllë strategjike synon të avancojë transformimin digjital të Universitetit të Prishtinës përmes integritetit sistematik të teknologjive digjitale në të gjitha aspektet e veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative. Transformimi digjital do të shërbejë si katalizator për rritjen e cilësisë, efikasitetit, inovacionit dhe konkurrueshmërisë institucionale.

Universiteti do të digjitalizojë proceset akademike dhe administrative për të rritur efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve për studentët dhe stafin. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të sistemeve inteligjente të menaxhimit, përdorimit të të dhënave për vendimmarrje të bazuar në evidencë dhe avancimit të qeverisjes digjitale.

Po ashtu, do të promovohet përdorimi inovativ, etik dhe i përgjegjshëm i teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në mësimdhënie, vlerësim, kërkim shkencor dhe administrim universitar. Në këtë kuadër, universiteti do të forcojë integritetin akademik, kompetencat digjitale dhe kapacitetet e stafit dhe studentëve për përdorimin efektiv të teknologjive të reja.

Transformimi digjital do të mbështesë zhvillimin e mësimi hibrid, avancimin e përvojës studentore dhe modernizimin e infrastrukturës teknologjike, përfshirë rrjetet, sistemet e menaxhimit të të nxënësve, shërbimet digjitale dhe platformat e bashkëpunimit akademik. Paralelisht, universiteti do të forcojë sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe qëndrueshmërinë e sistemeve digjitale, duke krijuar bazat për zhvillimin e një universiteti inovativ dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Objektivi strategjik 6	Përshpejtimi i transformimit digjital dhe zhvillimi i një infrastrukture universitare moderne që mbështet mësimdhënien, kërkimin dhe vendimmarrjen.
Objektivat specifike	OS 6.1 – Digjitalizimi i proceseve akademike dhe administrative OS 6.2 – Integrimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe kërkim shkencor

	OS 6.3 – Promovimi i integritetit akademik dhe përdorimit të përgjegjshëm të inteligjencës artificiale
	OS 6.4 – Forcimi i sigurisë digjitale dhe mbrojtjes së të dhënave
	OS 6.5 – Modernizimi i infrastrukturës digjitale dhe teknologjike

Objektivi specifik 6.1	Aktivitetet
Digjitalizimi i proceseve akademike dhe administrative	6.1.1 – Funksionalizimi i sistemit ERP akademik (SEMS) 6.1.2 – Digjitalizimi i proceseve për menaxhimin e tezave dhe disertacioneve 6.1.3 – Zhvillimi i <i>One-Stop Student Portal</i> 6.1.4 – Implementimi i nënshkrimit elektronik 6.1.5 – Trajnimi i stafit për sistemet digjitale dhe AI 6.1.6 – Digjitalizimi i proceseve që lidhen me programet studimore në njësitë akademike, përfshirë krijimin, rishikimin, aprovimin, monitorimin dhe qarkullimin elektronik të dokumentacionit

Objektivi specifik 6.2	Aktivitetet
Integrimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe kërkim shkencor	6.2.1 – Implementimi i platformave LMS me AI 6.2.2 – Zhvillimi i asistentëve akademikë virtualë (<i>chatbots</i>) 6.2.3 – Integrimi i AI në kurrikula 6.2.4 – Krijimi i Qendrës për AI 6.2.5 – Organizimi i aktiviteteve inovative (<i>hackathons</i>)

Objektivi specifik 6.3	Aktivitetet
Promovimi i integritetit akademik dhe përdorimi i përgjegjshëm i inteligjencës artificiale	6.3.1 – Hartimi i rregullores për përdorim të përgjegjshëm të AI 6.3.2 – Zhvillimi i mekanizmave për integritet akademik dhe parandalim të plagjiaturës 6.3.3 – Krijimi i Komitetit të Integritetit Akademik 6.3.4 – Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse mbi integritetin akademik 6.3.5 – Trajnimi i stafit akademik për vlerësim dhe integritet akademik në epokën e inteligjencës artificiale, përmes zhvillimit të metodave të vlerësimit që nxisin mendimin kritik, kreativitetin dhe përdorimin etik të AI-së

Objektivi specifik 6.4	Aktivitetet
Forcimi i sigurisë digjitale dhe mbrojtja e të dhënave	6.4.1 – Krijimi i sistemit qendror të menaxhimit të të dhënave (<i>Data Warehouse</i>) 6.4.2 – Krijimi i sistemit informativ për kërkim dhe bazave të të dhënave institucionale. 6.4.3 – Krijimi i Qendrës për Operime të Sigurisë Kibernetike (SOC)

	6.4.4 – Ndërtimi i laboratorit të sigurisë kibernetike
	6.4.5 – Trajnimi i stafit akademik, administrativ dhe studentëve për siguri dhe mbrojtje të të dhënave

Objektivi specifik 6.5	Aktivitetet
Modernizimi i infrastrukturës digjitale dhe teknologjike	6.5.1 – Modernizimi i Data Center me infrastrukturë softuerike
	6.5.2 – Zbatimi i funksioneve për monitorim dhe menaxhim të rrjetit dhe infrastrukturës së IT-së (NOC)
	6.5.3 – Pajisja e sallave me tabela të zgjuara (smart)
	6.5.4 – Zhvillimi i arkitekturës <i>hybrid cloud</i> dhe sistemeve për rikuperim nga fatkeqësitë (DR)
	6.5.5 – Pajisja e sallave mësimore me teknologji audio-vizuale dhe mjete për mësim hibrid dhe incizim të ligjëratave, me qëllim të mbështetjes së qasjes fleksibile në mësim dhe përmirësimit të cilësisë së procesit mësimor
	6.5.6 - Modernizimi dhe zgjerimi i rrjetit Wi-Fi në të gjitha njësitë akademike dhe hapësirat universitare për të siguruar qasje të qëndrueshme, të sigurt dhe me shpejtësi të lartë në internet

Treguesit e performancës për objektivin strategjik 6

Treguesi kryesor (KPI)	Synimi 2030
% e stafit dhe studentëve të trajnuar për siguri digjitale, integritet akademik dhe përdorim të përgjegjshëm të AI-së	≥ 80%
% e programeve studimore dhe stafit që përdorin teknologji digjitale dhe AI në mësimdhënie, kërkim dhe administrim	≥ 70%
Niveli i funksionalizimit dhe sigurisë së infrastrukturës digjitale institucionale	≥ 100% e sistemeve kritike të mbuluara me standarde të sigurisë dhe vazhdimësisë operative

7. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2026–2030

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit Strategjik 2026–2030 paraqet një komponent thelbësor për sigurimin e realizimit efektiv të objektivave strategjike dhe forcimin e llogaridhënies institucionale në Universitetin e Prishtinës. Përmes një sistemi të strukturuar të monitorimit dhe raportimit, universiteti synon të sigurojë përcjellje të vazhdueshme të progresit, identifikim të hershëm të sfidave dhe ndërmarrje të masave korrigjuese për arritjen e rezultateve të planifikuara.

Zbatimi i strategjisë do të operacionalizohet përmes hartimit të Planit të Veprimit 2026–2028, i cili do të përcaktojë aktivitetet konkrete, afatet kohore, njësitë përgjegjëse dhe indikatorët për secilin objektiv strategjik dhe specifik. Plani i veprimit do të shërbejë si dokument udhëzues për koordinimin institucional dhe realizimin gradual të prioriteteve strategjike të universitetit.

Për të siguruar mbikëqyrje të strukturuar të procesit të zbatimit, Këshilli Drejtues do të emërojë Komisionin për Monitorimin e Planit Strategjik, i cili do të ketë përgjegjësi për shqyrtimin e progresit të zbatimit, analizimin e raporteve periodike dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e performancës institucionale. Komisioni do të bashkëpunojë ngushtë me Rektoratin, njësitë akademike dhe administrative në procesin e monitorimit dhe raportimit.

Për të mbështetur monitorimin dhe vendimmarrjen e bazuar në evidencë, Universiteti i Prishtinës do të zhvillojë një platformë digjitale institucionale për monitorimin në kohë reale të zbatimit të aktiviteteve dhe indikatorëve të performancës. Platforma do të mundësojë raportim sistematik, analizë të progresit, identifikim të vonësive apo sfidave në implementim dhe gjenerim të raporteve të nevojshme për organet drejtuese të universitetit. Të dhënat e gjeneruara nga platforma do të shërbejnë si bazë për monitorimin e progresit dhe ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese kur është e nevojshme.

Monitorimi i strategjisë do të bazohet në tregues të matshëm të performancës (KPI), të cilët mundësojnë vlerësimin objektiv të progresit institucional në fusha si cilësia akademike, përvoja studentore, kërkimi shkencor, ndërkombëtarizimi, qeverisja dhe transformimi digjital. Njësitë akademike dhe administrative do të kenë përgjegjësi për raportimin vjetor të progresit në realizimin e aktiviteteve dhe objektivave përkatëse. Raportet vjetore të progresit do të diskutohen në organet drejtuese të universitetit.

Në mes të periudhës strategjike mund të realizohet një vlerësim ndërmjetësues i progresit, me qëllim të identifikimit të sfidave, rishikimit të prioriteteve dhe përshtatjes së aktiviteteve në përputhje me zhvillimet institucionale, financiare dhe teknologjike.

Në përfundim të periudhës strategjike do të realizohet një vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të strategjisë, me qëllim të analizimit të ndikimit institucional, nivelit të arritjes së objektivave dhe identifikimit të mësimave të nxjerra për ciklet e ardhshme të planifikimit strategjik.

8. Ndikimet financiare dhe qëndrueshmëria e zbatimit

Zbatimi i Planit Strategjik 2026–2030 do të kërkojë planifikim të kujdesshëm financiar, priorizim të aktiviteteve dhe mobilizim të burimeve të ndryshme financiare. Universiteti do të zbatojë qasje graduale dhe të bazuar në prioritetet strategjike, duke harmonizuar objektivat e strategjisë me planifikimin buxhetor institucional dhe kapacitetet reale financiare të universitetit.

Financimi i zbatimit të strategjisë do të mbështetet në burime të ndryshme financiare, duke përfshirë buxhetin publik të ndarë për Universitetin e Prishtinës, financimin e bazuar në performancë, projektet dhe grantet ndërkombëtare, programet e Bashkimit Evropian, partneritetet me sektorin privat, donacionet, si dhe gjenerimin e të hyrave përmes aktiviteteve akademike, kërkimore dhe shërbimeve të konsulencës.

Universiteti do të synojë të forcojë kapacitetet institucionale për aplikim dhe menaxhim të projekteve ndërkombëtare, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në programe si Erasmus+, Horizon Europe dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare për arsim, kërkim dhe inovacion. Në të njëjtën kohë, universiteti do të promovojë modele të qëndrueshme të menaxhimit financiar dhe priorizimit të investimeve strategjike, veçanërisht në fushat e kërkimit shkencor, transformimit digjital, infrastrukturës moderne dhe ndërkombëtarizimit.

Ndikimet financiare të aktiviteteve strategjike do të detajohen më tej në planet e veprimit, të cilat do të përcaktojnë prioritetet, afatet kohore, përgjegjësitë institucionale dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave strategjikë. Për të mbështetur planifikimin dhe zbatimin efektiv të strategjisë, menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës do të përgatisë gjithashtu një dokument të veçantë për kostimin e strategjisë, i cili do të identifikojë kostot e parashikuara të aktiviteteve prioritare, burimet potenciale të financimit dhe implikimet buxhetore të zbatimit të saj.

Dokumenti i kostimit do të shërbejë si instrument mbështetës për planifikimin financiar afatmesëm dhe afatgjatë, duke mundësuar lidhjen ndërmjet prioritetëve strategjike, planeve të veprimit dhe kapaciteteve financiare të universitetit. Ai do të kontribuojë në vendimmarrje më efektive, priorizim të investimeve dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e burimeve financiare.

Përmes një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme financiare, Universiteti i Prishtinës synon të krijojë kushtet e nevojshme për realizimin e prioritetëve strategjike dhe për forcimin e rolit të tij si institucion modern, konkurrues dhe i orientuar drejt zhvillimit afatgjatë.

9. Shtojcat

9.1. Lista e dokumenteve referuese

Gjatë hartimit të Planit Strategjik 2026–2030 të Universitetit të Prishtinës janë analizuar dhe përdorur dokumente institucionale, ligjore dhe strategjike relevante në nivel universitar, kombëtar dhe ndërkombëtar. Lista e dokumenteve referuese përfshin, por nuk kufizohet në, dokumentet e mëposhtme:

1. Statuti i Universitetit të Prishtinës
2. Plan i Strategjik i Universitetit të Prishtinës 2023–2025
3. Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Planit Strategjik 2023–2025
4. Vendimi për themelimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Strategjik 2026–2030
5. Strategjia e Arsimit të Republikës së Kosovës 2022–2026
6. Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës
7. Udhëzimi Administrativ për Financimin e Bazuar në Performancë të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë
8. Korniza Evropiane e Arsimit të Lartë (European Higher Education Area – EHEA)
9. Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG)
10. Dokumentet dhe prioritetet e Procesit të Bolonjës
11. Strategjia e Universitetit të Lubjanës 2022–2027
12. Dokumente dhe raporte relevante të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA)
13. Raporte dhe dokumente relevante të Erasmus+, Horizon Europe dhe programeve të tjera të Bashkimit Evropian
14. Raporte, analiza dhe materiale të zhvilluara gjatë procesit konsultativ me njësitë akademike, studentët dhe palët e tjera të interesit
15. Dokumente të tjera strategjike, ligjore dhe institucionale relevante për zhvillimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe transformimit digjital.

9.2. Lista e pjesëmarrësve në procesin konsultativ

Procesi i hartimit të Planit Strategjik 2026–2030 është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe konsultative, duke përfshirë aktorë të ndryshëm institucionalë, akademikë, publikë, privatë dhe ndërkombëtarë. Konsultimet dhe aktivitetet e realizuara gjatë procesit kanë synuar sigurimin e përfshirjes së gjerë, reflektimin e nevojave reale të universitetit dhe harmonizimin e prioritetëve strategjike me zhvillimet në arsimin e lartë dhe tregun e punës.

Në procesin konsultativ kanë marrë pjesë këto kategori institucionesh dhe aktorësh:

- Strukturat dhe organet e Universitetit të Prishtinës
 - Këshilli Drejtues
 - Senati
 - Rektori
 - Prorektorët
 - Njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës
 - Institutet dhe qendrat universitare
 - Njësitë për sigurimin e cilësisë
 - Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
 - Shërbimet administrative dhe teknike
 - Shërbimet e IT-së
 - Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare
 - Zyra për Karrierë dhe Alumni
 - Përfaqësuesit e studentëve dhe Alumni
- Partnerët akademikë dhe ndërkombëtarë
- Sektori privat dhe tregu i punës
- Donatorët dhe programet mbështetëse

9.3. Plani i Veprimit 2026-2028